

1 E enjte, 13 shkurt 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare, ju
6 lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës, kjo është lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqi.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
12 procesverbal të katër të akuzuarit janë të pranishëm në sallën
13 e gjyqit.

14 Javën tjetër, t'ju kujtoj që të hënën nuk do kemi seancë,
15 domethënë do kemi nga e marta deri të premtën.

16 Pikësëpari, dëshiroj të them që të akuzuarit duhet të
17 presin që të marrin autorizimin nga Gjykatësit në mënyrë që të
18 flasin në gjyq, sidomos kur është duke folur dëshmitari. Nëse
19 të akuzuarit kanë nevojë të flasim me avokatin e tyre, të
20 lutem, kontaktoni një nga anëtarët e ekipit që keni afër që të
21 komunikoni me avokatin tuaj. Ne do të bëjmë një pauzë patjetër
22 që t'ju japim ju mundësinë të flisni me avokatin tuaj.

23 Ju lutem dhe avokatëve të sigurojnë që të mos ndërpresim
24 dëshminë e dëshmitarit.

25 Së dyti, ZPS-ja ka kërkuar që të pranohet transkripti i

1 një video të TPNJ-së dhe është pranuar nga Trupi Gjykses me
2 Dëshmitarin W04290, e datës 19 nëntor 2003. Dhe numri që iu
3 dha këtij materiali është P02026.

4 Trupi Gjykses vëren, sidoqoftë, që ZPS-ja nuk kërkoi që
5 të pranohej -- pra, ka kërkuar transkriptin po jo videon që të
6 pranohej, kështu që dëshirojmë të pyesim ZPS-në a doni që të
7 pranohet dhe video?

8 Z. HALLING: [Përkthim] Po, do të donim që të pranohej dhe
9 videoja?

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] ka ndonjë
11 kundërshtim nga ekipet e Mbrojtjes lidhur me videon, me
12 materialin filmik që të përkrah transkriptit të pranojmë dhe
13 videon sepse kjo është më e plotë dhe na ndihmon të gjithëve.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
16 atëherë. Përfshini në provën P02026 videon përkatëse.

17 Sekretare e seancës, mund të bëhet kjo?

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Patjetër që po.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do të
20 vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë W04290.

21 Ju lutem sillni dëshmitarin.

22 [Dëshmitari vijon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,
24 z. Selimi.

25 DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej për
2 procesverbal që dhe Avokati Kujdestar, z. Qerkini është i
3 pranishëm në sallën e gjyqit sikurse ka qëndruar dhe ditët e
4 tjera.

5 Z. Selimi, ju lutem përgjigjuni qartë me fjali të
6 shkurtër. Nëse nuk e kuptoni një pyetje lirisht kërkoni që
7 pyetje të përsëritet ose thoni që nuk e kuptoni në mënyrë që
8 ta sqarojmë. Gjithashtu, mos harroni të na e thoni mbi ç'bazë
9 i jepni faktet dhe rrethanat për të cilat ju bëjnë pyetje.

10 Ju rikujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të
11 vërtetën sikurse vetë e thatë përmes betimit solemn. Dhe ju
12 rikujtoj se garancitë që ju ofruam ditën e hënë ne si Trupi
13 Gjykues gjegjësisht, që përgjigjet që do të jepni ju nuk do të
14 përdoren as drejtpërsëdrejti as tërthorazi në asnjë proces të
15 mëpasshëm penal përpara Dhomave të Specializuara, me
16 përjashtim të nenit 15(2) dhe rregullës 65 të rregullores.
17 Pra, garancitë vlejné ende.

18 Dhe mosdhënia e dëshmisë mund të gjobet -- mund të
19 sanksionohet me një gjobë - më falni.

20 Flisni pranë mikrofonit, bëni një pauzë prej pesë
21 sekondash përpara se të përgjigjeni, dhe ju lutem flisni
22 ngadalë dhe me zë të lartë, ju lutem, për përkthyesit.

23 Në çdo çast që keni nevojë për pushim na thoni dhe do të
24 bëjmë organizimin përkatësit.

25 Vazhdojmë tani me pyetjet e Gjykatësve. Tani e ka radhën

1 Gjykatësi Mettraux, që është ulur në të djathtën time, në të
2 majtën tuaj.

3 DËSHMITARI: SYLEJMAN SELIMI [Vijon]

4 Pyetje nga Trupi Gjykses: [Vazhdim]

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëmëngjes, z. Selimi.

6 PË. Mirëmëngjes.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua të flasim bashkë
8 lidhur me disa fakte dhe rrethana që keni diskutuar me palët
9 në këtë sallë gjyqi, sepse dua të jem pak më i qartë vetë
10 lidhur me disa nga aspektet për të cilat keni dhënë dëshmi.
11 Dua të filloj me dëshminë që keni dhënë për grupin e Prekazit,
12 për kontekst. E kuptoni këtë?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e vërtetë që
15 sikurse e thatë dhe ju javën e kaluar, këtë javë për ZPS-në,
16 ju e keni ditur para luftës që Adem Jashari kishte kontakte të
17 rregullta me Shtabin e Përgjithshëm. A konfirmoni këtë?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ta kuptoj unë kështu,
20 domethënë, që ju këtë e keni ditur sepse ai, Adem Jashari ua
21 ka thënë ju vetë këtë gjë, apo e keni marrë këtë informacion
22 nga një person i tretë?

23 PË. Jo, nuk e kam dit, por e kam dit që Adem Jashari ka
24 kontakte me persona të tjerë dhe me grupet e tjera nëpër
25 gjithë Zonën Operative të Drenicës, por edhe jashtë saj edhe

1 në perëndim.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ju lexoj atë që keni
3 thënë. Shënimi Përgatitor numër 1, që është tashmë pjesë e
4 provave gjyqësore me numër P2029, paragrafi 13. Ju thatë:

5 "Adem Jashari ka qenë në kontakte të vazhdueshme me
6 Shtabin e Përgjithshëm ..."

7 A është e saktë kjo që thuhet në shënimin përgatitor?
8 PË. Në atë kohë nuk e di sa ka pas Shtabi i Përgjithshëm, por
9 me persona të ndryshëm dhe me njerëz të ndryshëm me grupe të
10 ndryshme e di që Adem Jashari ka pas në përgjithësi me të
11 gjithë njerëzit kontakt dhe në këtë aspekt kam mendu.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ndryshoni dëshminë tuaj
13 tani? Tani po thoni që nuk e dini a ka pas kontakte Adem
14 Jashari me Shtabin e Përgjithshëm?

15 PË. E di si Adem Jashari ka pas kontakte me të gjithë
16 njerëzit të cilët kanë qenë përreth tij edhe kontaktet e tijna
17 direkte nuk i di me kon e ka pas. Unë e di që ka pas me shumë
18 njerëz dhe me shumë grupe. Edhe ka qenë kryesori në Ushtrinë
19 Çlirimtare të Kosovës.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sepse kur keni dhënë
21 dëshmi në betim para ish-Tribunalit të Hagës, në janar 2005,
22 jeni pyetur në sallën e gjyqit në qoftë se gjatë kësaj
23 periudhe kohore Adem Jashari ka qenë në kontakt me Shtabin e
24 Përgjithshëm. Për procesverbal, po lexoj provën P2027 faqja
25 260-2601 [Sipas përkthimit]. Ju thatë:

1 "Po". Dhe jeni përgjigjur me "po". "Është normale që Adem
2 Jashari të kishte kontakte me Shtabin e Përgjithshëm, dhe ai
3 kishte kontakte për të cilat unë nuk isha në dijeni, se nuk
4 isha në atë nivel që të dija veprimtaritë e tij me Shtabin e
5 Përgjithshëm. Por, dihej që ai kishte kontakte jo vetëm me
6 Shtabin e Përgjithshëm, por edhe me shtete të tjera, me sa kam
7 unë dijeni."

8 Dhe vijon më pas dëshmia. Pra, unë po ua bëj dhe një herë
9 pyetjen: Keni pasur dijeni në atë kohë apo mësuat gjë më vonë
10 që Adem Jashari të ketë pasur kontakte të vazhdueshme, sipas
11 fjalëve tuaja, me Shtabin e Përgjithshëm përpara luftës?
12 PË. Unë po them prapë po të njëjtën gjë, po e them edhe tash.
13 Të njëjtën gjë po e them edhe atëherë që kam deklaruar, Adem
14 Jashari ka pasur kontakte me të gjithë dhe në atë kohë, si
15 Shtabi i Përgjithshëm unë nuk ka ekzistuar dhe ku është, por ka
16 pasur kontakte me Shtabin, me anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm
17 dhe me njerëz të gjithë.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani e kemi të qartë, po.
19 Pra, ju e keni ditur në veçanti dhe uroj të na e konfirmoni
20 këtë, ju e dini që ai ka pasur në veçanti kontakte me djalin e
21 axhës suaj, Rexhep Selimin përpara luftës, apo jo?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe ju këtë e dini sepse
24 ju i keni prezantuar ata me njëri-tjetrin, apo jo?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtë kontakt mes Adem
2 Jasharit dhe Rexhep Selimit që e mundësuat ju, e keni
3 mundësuar në vitin 1994, saktë?

4 PË. Po.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Gjithashtu, ju e keni
6 ditur dhe uroj ta konfirmoni këtë se Hashim Thaçi, Kadri
7 Veseli dhe Jakup Krasniqi kishin po ashtu kontakte dhe disa
8 prej tyre dhe takime me Adem Jasharin përpara luftës. E
9 konfirmoni këtë?

10 PË. Unë në takime nuk kam qenë prezent, po une mendoj që dhe
11 e di që kanë kontakte.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe në fakt, ju e dini
13 këtë në veçanti sepse z. Veseli dhe z. Thaçi e kanë thënë këtë
14 në praninë tuaj, apo jo?

15 PË. Jo, në praninë time nuk e kanë thënë, por --

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirë e flasim pak më vonë
17 këtë.

18 Shohim fillimisht këtë provën materiale P186, P186, ju
19 lutem.

20 A ju kujtohet tua kenë treguar këtë dokument në fillim të
21 kësaj jave?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Është një procesverbal i
24 një takimi mbajtur në shtëpinë e Jasharëve në kullën e
25 Jasharëve në Prekaz, më 18 shkurt 2001, dhe të pranishëm, ndër

1 të tjerë, jeni ju, personalisht, Hashim Thaçi, Gani Koci dhe
2 Kadri Veseli A ju kujtohet ky takim?

3 PË. Po.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të shkojmë në faqen e
5 katër të dokumentit me ERN 00226188.

6 Në anglisht dua të shohim pjesën që lidhet me Hashim
7 Thaçin. Poshtë Sami Lushtakut shohim emrin e z. Hashim Thaçi.
8 E shihni?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në anglisht thuhet kështu:
11 "Adem Jashari ka qenë i informuar për themelimin e UÇK-
12 së. Janë mbajtur shumë mbledhje dhe janë dhënë shumë mendime."

13 E patë këtë?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë më poshtë në faqe.
16 Është një paragraf tjetër që lidhet me z. Thaçi këtu, poshtë
17 Kadri Veselit. E shihni?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Thuhet kështu:

20 "Propozimi për emrin në UÇK ... është nga Kosova. Dihet
21 dokumenti që ka nënshkruar Ahmet Haxhiu në 1992, të cilin unë
22 ja kam sjellë Adem Jasharit."

23 E shihni këtë?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër.

1 Shkojmë në fund tek anglishtja dhe tek shqipja.

2 Është po ashtu një paragraf që lidhet me Kadri Veselin,
3 poshtë Gani Kocit, e shihni?

4 PË. Po.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ajo që thuhet këtu që
6 pretendohet se ka thënë z. Veseli, është që të gjithë e dimë
7 që ne kemi ardh tek Ademi dhe çdo gjë është vendosur në kullën
8 e Adem Jashari, komandant është dhe ka qenë Adem Jashari."

9 E shihni?

10 PË. Po.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër.

12 Me germa të errëta poshtë numrit 3, thuhet që:

13 "Personat -- këta persona kanë marrë pjesë në një
14 mbledhje, takim që është mbajtur në kullën e Adem Jasharit në
15 prill 1993."

16 Dhe ndër të tjerë këtu janë Kadri Veseli, Jakup Krasniqi,
17 Hashim Thaçi. I shihni emrat, e shihni këtë?

18 PË. Po, e saktë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani pamë procesverbalin e
20 një takimi ku keni qenë dhe ju pjesëmarrës. A ju ndihmon kjo
21 që t'ju rikujtohet fakti që z. Thaçi dhe z. Veseli e kanë
22 thënë në praninë tuaj se janë takuar me Adem Jasharin përpara
23 luftës?

24 PË. Me -- ky takim shihet që është mbajt mbas lufte dhe është
25 fol për rrjedhat e mëhershme, por unë nuk e mbaj mend bisedat

1 të cilat janë ba. E di që kam qenë në atë takim, takimi ka
2 qenë gjithëpërfshirës dhe për secilin ça ka thonë në atë kohë,
3 nuk e di, se s'e mbaj mend.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kuptoj.

5 Ju lutem i rikthehemi faqes së parë të dokumentit.

6 Ju lutem, shihni listën e pjesëmarrësve. Personat në këtë
7 listë përfshirë edhe ju, a janë të gjithë nga regjioni i
8 Drenicës?

9 PË. Po, të gjithë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përfshirë z. Thaçi dhe z.
11 Veseli, apo jo?

12 PË. Z. Veseli nuk e di që është -- z. Veseli nuk është prej
13 Drenice.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po z. Krasniqi? Po ai, kur
15 them z. Krasniqi, e kemi fjalën për z. Jakup Krasniqi? Po ai
16 nga Drenica është?

17 PË. Po.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Rexhep Selimi?

19 PË. Edhe ky prej Drenice, po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Edhe ju vetë, apo jo?

21 PË. Po, gjithashtu.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet kush e ka
23 organizuar këtë mbledhje?

24 PË. Jo, nuk më kujtohet.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet kush ju ftoi

1 ju personalisht të merrnit pjesë?

2 PË. Saktësisht nuk më kujtohet. Dikush prej familjes, po
3 Rifati apo dikush, nuk e di që më ka thirr në takim.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E keni fjalën familja e
5 Adem Jasharit?

6 PË. Nuk jam i saktë, po dikush prej tyre më ka tregu, po, për
7 familjen Jashari, për familjen e Adem Jasharit.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Javën e kaluar - dhe nëse
9 dëshironi mund të shohim edhe procesverbalin e asaj që keni
10 thënë - pra javën e kaluar i keni thënë Prokurorisë, në
11 Shënimin Përgatitor numër 1, paragrafi 13, se ju e dinit se
12 Adem Jashari merrte urdhra prej Shtabit të Përgjithshëm. Ju
13 kujtohet ta keni thënë këtë?

14 PË. Adem Jashari ka qenë kryesori edhe ka qenë komandant i
15 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pika reference dhe takimet e
16 mia kanë qenë direkte me të. Dhe Adem Jashari ka pas kontakte
17 me të gjithë.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk është kjo pyetje. Ju
19 lutem, dëgjojeni me vëmendje. Fokusohuni tek pyetja ime, ju
20 lutem.

21 Ju keni thënë vetë javën e kaluar në seancën përgatitore
22 me Prokurorinë dhe kjo është zbardhur në paragrafin 13, dhe
23 nëse doni unë jua lexoj. Pra, ju keni thënë që Adem Jashari
24 merrte urdhra prej Shtabit të Përgjithshëm. A ju kujtohet ta
25 keni thënë këtë?

1 PË. Atëhere është gabim, se Adem Jashari nuk ka marrë urdhra
2 nga Shtabi i Përgjithshëm, po ka dhënë urdhra ose është
3 konsultu me Shtabin e Përgjithshëm. Me njerëz të cilët i ka
4 njoft.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, po e ndryshoni këtë
6 që keni thënë? Pra, javën e kaluar Adem Jashari merrte urdhra,
7 sot, Adem Jashari i jepte urdhra Shtabit të Përgjithshëm? Pra
8 kjo është dëshmia e sotme?

9 PË. Unë mendoj që ka qenë gabim. Adem Jashari nuk ka -- nuk
10 besoj që kam thënë ka dhënë urdhra dhe ka marrë urdhra, në
11 aspektin kam thënë "ka dhënë urdhra". Ka mund të jep urdhra se
12 Adem Jashari s'ka mund të merr urdhra nga dikush tjetër. Adem
13 Jashari ka qenë komandant kryesor. Pa Adem Jasharin s'kishte
14 as UÇK-së, s'kishte me pas.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të
16 vendosi në ekran videon e intervistës së z. Selimi me TPNJ-në.
17 Është pjesë e provave gjyqësore me numër P2026. ERN V00-4792
18 [Sipas përkthimit]. Dhe shohim segmentin kohor, minuta 52,
19 sekonda e - më falni 50:30. Minuta 50, sekonda 30.

20 Do t'ju tregoj diçka që e pamë edhe në fillim të kësaj
21 videoje. Është video e intervistës, incizimi i intervistës
22 suaj me TPNJ-në.

23 Për procesverbal, transkripti përkatës gjendet në faqen
24 15 dhe 16. Dëgjojeni me vëmendje, z. Selimi, dhe më pas do
25 t'ju bë pyetjet e mia.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo duhet bërë në seancë publike?

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk mendoj që ka ndonjë
3 problem.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Në rregull dhe për ne.

5 [Luhet videoincizimi]

6 "Kush ishin këta komandantët që ishin përgjegjës për
7 Drenicën?

8 "Në këtë kohë hala vetëm, vetëm komandanti Adem Jashari,
9 domethënë. [E pakuptueshme] domethënë, ishim krejt bërthamë e
10 tij, krejt i grup i tija [E pakuptueshme], edhe ai është me
11 formim me ardhjen e njerëzve të ndryshëm, vullnetarëve [E
12 pakuptueshme] atëherë filloi edhe zgjenimi. Ky ka qenë edhe
13 qëllimi jonë që të -- sa ma shumë të rekrutohen njerëz,
14 domethënë.

15 "Po Adem Jashari, në qoftë se e dini, Adem Jashari vetë,
16 a kontaktonte ndonjëherë, a raportonte ndonjëherë ke Shtabi i
17 Përgjithshëm?

18 "Po, po, ai vazhdimisht e ka pas lidhjen, domethënë, me
19 Shtabin e Përgjithshëm.

20 "Ai, ai gjithmonë ka qenë, domethënë, në kontakt të
21 vazhdueshëm me Shtabin e Përgjithshëm, me Shtabin e
22 Përgjithshëm, ata anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm gjithmonë
23 janë konsultu me Adem [E pakuptueshme], edhe ky ka qenë figura
24 kryesore e ushtrisë.

25 "Unë e di që në këtë -- në këtë kohë Drenica ishte baza

1 kryesore në Kosove ose pika, qendra kryesore në Kosovë. Pra
2 kishte dhe zona të tjera në Kosovë ku po ndodhte e njëjta gjë?

3 "Normal, në këtë -- në këtë -- në këtë kohë ka pas edhe
4 në për vende të ndryshme, si në Dukagjin edhe në Llap, po ka
5 pas edhe ma herët, po nuk kam mujt me i njoft tanëve,
6 domethënë, në këtë periudhë [E pakuptueshme] kanë qenë anëtarë
7 të Shtabit të Përgjithshëm të cilët i kanë pas njerëzit e vet
8 dhe në, domethënë, në të gjitha zonat.

9 "Shtabi i Përgjithshëm mendon që kishin një plan, e
10 kontrollonin këta se ç'po ndodhte në Llap, në Dukagjin apo në
11 [E pakuptueshme]?"

12 "Normal, çdo gjë që është bo është bo me plan të Shtabit
13 të Përgjithshëm domethënë. Edhe, për shembull, ta zëmë në
14 Drenicë atëherë është komunikuar prej komandantit, domethënë,
15 komandantit legjendar Adem Jasharit që është dhënë detyrat e
16 tona. Mirëpo, njëkohësisht edhe nëpër zona të tjera të njëjtin
17 plan e kanë bo edhe prej Shtabit të Përgjithshëm për zona të
18 tjera. Domethënë, të gjitha kanë qenë në kontroll, gjërat kanë
19 qenë të kordinume nga Shtabi i Përgjithshëm. Çdo send,
20 domethënë, çdo gjë ka qenë e organizime nga Shtabi i
21 Përgjithshëm."

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani ju ndihmoi kjo z.
23 Dëshmitar, t'ju kujtohet tani prej nga vinin urdhrat dhe në
24 drejtim të kujt shkonin, cili ishte drejtimi i urdhrave?
25 PË. Po nuk e di a ka kuptim nëse Adem Jashari s'ka qenë

1 anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Unë e kam spjegu si ka shku,
2 po Adem Jashari ka qenë kryesor, organizmin nëpër --

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jo, jo, jo. Jo, Dëshmitar.
4 Nuk po ju pyes këtë. Unë po ju pyes kështu: Ju e dëgjuat vetë
5 tani kur thatë kush jepte urdhra kujt.

6 PË. Unë çdo herë mund të them që kryesor me Ushtria
7 Çlirimtare e Kosovës ka qenë Adem Jashari. Unë e kam shpjegu
8 se si ka -- si unë kam mendu nga -- dhe si është organizu
9 Shtabi i Përgjithshëm nga mendimi jem, por duke e dit që s'kam
10 qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, unë kam jep ato
11 mendimet e mia.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kuptoj. Tani do t'ju pyes
13 për rolin tuaj si komandant i përgjithshëm i UÇK-së. Do t'ju
14 them si i kam kuptuar unë rrethanat. Dhe më pas do t'ju bëj
15 pyetjen.

16 Pra, diku mes apo fund shkurti 1999, ju u zgjodhët si
17 komandanti i ri i përgjithshëm i UÇK-së. E kam kuptuar saktë?
18 PË. Saktë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Javën e kaluar, ju i thatë
20 Prokurorisë - kjo është në Shënimin Përgatitor numër 1,
21 paragrafi 6 - se nuk mund t'i ushtronit funksionet tuaja si
22 komandant i përgjithshëm derisa të kthehej delegacioni i
23 Rambujesë sepse ju duhet të komunikoni me ta paraprakisht. A
24 ju kujtohet ta keni thënë këtë, dhe a është kjo e vërtetë?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në intervistën për gazetën
2 Zëri, që është me numër prove P1745, ju keni thënë, dhe po
3 citoj:

4 "Rexhep Selimi", flisni për këtë takim me komandantët e
5 zonave të tjera operative dhe me disa përfaqësues të Shtabit
6 të Përgjithshëm. Pra, ju keni thënë:

7 "Rexhep Selimi tha se UÇK-ja ... do të aprovonte cilindo
8 që do të zgjidhej komandant nga ky takim."

9 Saktë?

10 PË. Po.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe këtë e tha, në fakt,
12 dhe vetë z. Rexhep Selimi tek incizimi që pamë dje. Ju
13 kujtohet?

14 PË. Saktë.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, edhe përpara se të
16 caktoheshit ju dhe të zgjidheshit nga shokët tuaj, ishte rënë
17 dakord që Shtabi i Përgjithshëm do të aprovonte cilëndo
18 zgjedhje. Saktë?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtë javë, të martën, dhe
21 më konkretisht kjo jepet në faqen e procesverbalit 25021, keni
22 shpjeguar se komandanti -- komanda -- komandantët e zonave
23 operative ju përzgjedhën ju si komandant të përgjithshëm dhe
24 më pas juve u emëruat zyrtarisht nga Shtabi i Përgjithshëm. A
25 e kam kuptuar drejtë procesin e përzgjedhjes tuaj si komandant

1 i përgjithshëm, Dëshmitar?

2 PË. Po, saktë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më pas, mesa kam kuptuar
4 pas këtij takimi, ju jeni kthyer përsëri në Drenicë. A është e
5 saktë kjo?

6 PY. Po.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mesa kuptova unë, ju thatë
8 që ju nuk e keni marrë pozicionin e ri si komandant i
9 përgjithshëm i UÇK-së derisa morët miratimin e Shtabit të
10 Përgjithshëm. A është e saktë kjo?

11 PË. Këtë nuk -- nuk e di që e kam thonë, derisa e kam marrë
12 miratimin. Unë kam thanë që e ka marrë detyrën dhe menjëherë e
13 kam qëndru në Drenicë, nuk kam, nuk e kam shku në pjesë të
14 tjerë, por --

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju bëj disa pyetje të
16 tjera plotësuese lidhur me këtë. Kur u kthyet në Drenicë, a ju
17 zëvendësoi ju dikush si komandant i zonës operative?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na thoni se kur
20 ka ndodhur kjo?

21 PY. Po atë natë, kur unë jam zgjedh komandant i Shtabit të
22 Përgjithshëm. Njëkohësisht është zgjedh edhe komandanti në
23 vend tim kam qenë -- është emëru, është propozu ose është
24 emëru Sami Lushtaku.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kush caktoi ose emëroi

1 Sami Lushtakun për t'ju zëvendësuar juve në rolin tuaj të
2 mëparshëm?

3 PË. Aty për aty automatikisht ai ka qenë zëvendëskomandant
4 edhe i Zonës Operative të Drenicës, zëvendës i imi dhe kur kam
5 kalu në detyrën e komandantit të përgjithshëm ai ka kalu në
6 detyrën e komandantit të Zonës Operative të Drenicë. Nuk ka
7 pas ndonjë emërim ose ndonjë ...

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dëshiroj t'ju pyes lidhur
9 me atë çfarë keni bërë me rolin e ri që ju caktua në një
10 periudhë të shkurtër kur keni shërbyer si komandant i
11 përgjithshëm i UÇK-së.

12 Ne e dimë, sepse e keni thënë vetë ju, që ju jeni caktuar
13 për përgatitjet për Operacionin Shigjeta dhe jeni larguar
14 ditën e nesërme, a është e saktë kjo, Dëshmitar? Domethënë, e
15 latë pozitën tuaj një ditë më pas, a është e saktë kjo?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na tregoni se
18 çfarë tjetër keni bërë si komandant i UÇK-së gjatë këtyre
19 katër, pesë apo gjashtë javëve që keni shërbyer si komandant i
20 përgjithshëm?

21 PË. Mbasi jam zgjedh komandant i përgjithshëm jam shku e kam
22 mbajt një takim nuk e di mbas një jave a mbas -- e kam mbajt
23 një takim në Berishë ose në një fshat tjetër, nuk e di.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kush ka qenë i pranishëm
25 në atë takim?

1 PË. Ka qenë Bislam Zyrapi, Rexhep Selimi, më duket Fatmir
2 Limaj edhe nuk e di edhe disa të tjerë. Ka qenë më duket
3 komandant Drini dhe sa e di unë edhe dikush tjetër. Nuk e di.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Çfarë qëllimi apo çfarë
5 rezultati ka ndodhur pas atij takimi, çfarë produkti me fjalë
6 të tjera dha ai takim, çfarë ndodhi pas atij takimi?

7 PË. Takimi kurrëgjë, domethënë, është -- jam njoftu me ta.
8 Edhe është marrë që me propozim tyne që komandant Drini të
9 avanzon në Shtabin e Përgjithshëm, janë diskutu disa çështje
10 të cilat teknike. Nuk e di. Ka qenë më shumë takim njerëz mes
11 veti. Edhe unë, mbas këtij takimi, jam kthi prapë për Drenicë.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë përveç komandanti
13 Drini, lëvizjes së komandantit Drini, a ju kujtohet ndonjë gjë
14 tjetër për sa i takon vendimmarrjes në këtë takim pasi -- ç
15 tjetër është bërë në këtë takim me fjalë të tjera?

16 PË. Jo, s'e di. S'kujtohet.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Keni vendosur ndonjë gjë
18 tjetër në pozitën tuaj si komandant i UÇK-së?

19 Gjatë asaj kohe si komandant i UÇK-së, a i keni raportuar
20 ndokujt, Dëshmitar?

21 PË. Jo.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A keni pasur staf ose
23 personel që ju është dhënë nga Shtabi i Përgjithshëm për të
24 mbështetur rolin tuaj apo jeni mbështetur tek personeli tek
25 njerëzit që keni pasur tek zona e Drenicës?

1 PË. Jo. Për personel, kurrfarë personeli s'ka pasur as në
2 Shtabin e Përgjithshëm kur jam shku. Kanë qenë këta individë.
3 Kurse kur jam kthi kam qenë prapë me personelin tim, me
4 njerëzit e mi.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përveç këtij takimi që
6 sapo e diskutuam, gjatë kësaj periudhe kohe a jeni takuar
7 përsëri me ndonjë prej anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm
8 si, për shembull, me z. Thaçi, z. Veseli, z. Bashota, z.
9 Krasniqi, a jeni takuar me ndonjërin prej tyre ndërkohë që
10 keni qenë komandant i UÇK-së? Fatmir Limajn?

11 PË. Jo, nuk më kujtohet që jam taku.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A keni lëshuar ndonjë
13 komunikatë apo deklaratë politike gjatë kohës që keni qenë
14 komandant i përgjithshëm?

15 PË. Sa më kujtohet mu, jo.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A keni organizuar ndonjë
17 takim, keni pasur ndonjë takim ose kontakte me persona nga
18 drejtori të ndryshme të Shtabit të Përgjithshëm?

19 PË. Përveç me Bislum Zyrapi, nuk e di që kam pas takim.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, nuk keni pasur
21 kontakte, për shembull, me shefin për drejtorinë e zbulim
22 kundërzbulimit, nuk keni pasur kontakt as me shefin e
23 drejtorisë për policinë ushtarake, këtë po thoni, a është e
24 sakët kjo?

25 PË. Mesa më kujtohet s'kam pas kontakt.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Gjatë asaj kohe a keni
2 lëshuar ndonjë urdhër për anëtarë të tjerë të Shtabit të
3 Përgjithshëm?

4 PË. Jo, s'më kujtohet.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A keni lëshuar ndonjë
6 urdhër për ndokënd tjetër gjatë asaj kohe, urdhër të ndryshëm
7 nga ai që kishte të bënte me lëvizjen e komandant Drinit?

8 PË. Jo, nuk po më kujtohet.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani le të kalojmë në
10 fazën tjetër të karrierës tuaj, në qoftë se mund të shprehem
11 kështu, e kam fjalën konkretisht për periudhën e kohës kur u
12 krijua Qeveria e Përkohshme e Kosovës.

13 Do i kërkoj Sekretarisë që të paraqesë në ekran
14 dokumentin ERN 125424.

15 Për kontekst, Dëshmitar, më lejoni t'ju them që bëhet
16 fjalë për procesverbalin e takimit tuaj që keni pasur me ZPS-
17 në përpara një jave. Është Shënimi Përgatitor numër 2.
18 Fatkeqësisht nuk e kemi versionin në shqip, megjithatë do t'ju
19 lexoj pjesët përkatëse.

20 Dhe do i kërkoja Sekretarisë që të shkojë në faqen 15 të
21 Shënimit Përgatitor numër 2, ERN 125424 faqja konkrete është
22 125438 dhe dëshiroj që të shikoj paragrafin 91.

23 Në këtë paragraf thuhet si më poshtë, pra, kjo
24 pretendohet që ju t'i keni thënë Prokurorisë, z. Selimi. Po e
25 lexoj:

1 "Qeveria e Përkohshme e Kosovës gjithashtu u krijua në
2 këtë kohë, pak a shumë, në këtë kohë, ç'a do të thotë që ju",
3 domethënë, Dëshmitari 04290, "asnjëherë nuk ka raportuar
4 përpara qeverisë gjatë kohës që ka qenë komandant i
5 përgjithshëm."

6 Do përfundoj tek kjo fjali për momentin. A ju kujtohet që
7 gjatë kohës kur keni qenë komandant i përgjithshëm nuk i keni
8 raportuar asnjëherë Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, a është
9 saktë kjo, Dëshmitar?

10 PË. Po, e saktë.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më tej vijohet si më
12 poshtë:

13 "Kjo qeveri u krijua kur përfaqësuesit e të gjitha
14 partive politike u mbledhën me njëri-tjetrin dhe delegacioni i
15 drejtuar nga Hashim Thaçi mori mandatin për ta krijuar këtë
16 qeveri."

17 A ju kujtohet ta keni thënë edhe këtë, Dëshmitar?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më tej në tekst thuhet:

20 "Dëshmitari 04290", që jeni ju, "nuk e di ekzaktësisht
21 sesi ka raportuar Agim Çeku për Qeverinë e Përkohshme, por ai
22 duhet të ketë raportuar tek Ministria e Mbrojtjes dhe
23 eventualisht te kryeministri Hashim Thaçi."

24 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarisë
2 tani që të paraqesë në ekran provën P1101.

3 Dëshmitar, do ju lë një minutë që t'i hidhni një sy
4 dokumentit. Sikurse mund ta shikoni është raport luftarak që
5 mban datën 28 maj 1999.

6 Mbase do ishte më mirë që të kalojmë tek faqja tjetër dhe
7 pastaj do kthehemi përsëri tek faqja e parë.

8 Nëse e shihni në fund dokumentin, do vini re që është
9 dokument i cili është nënshkruar prej Agim Çekut në rolin e
10 vet si shef i Shtabit të Përgjithshëm. A e shikoni pjesën në
11 fund të dokumentit, Dëshmitar?

12 PË. Po, e saktë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të kthehemi tek faqja e
14 parë.

15 Pra, këtu thuhet që raporti i dërgohet ministrit të
16 mbrojtjes, z. Azem Syla. E shikoni këtë pjesën?

17 PË. Po, e saktë.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ky dokument a është në
19 përputhje me atë si e keni kuptuar ju situatën, domethënë, në
20 atë kohë, Adem Çeku, pra, i takon që në kapacitetin e vet Agim
21 Çeku, si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, do t'i ketë
22 raportuar ministrit të mbrojtjes, z. Azem Syla?

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Një korrigjim. "Duhet të ketë
24 raportuar" do ishte më mirë sesa formulimi që sapo bëtë.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është në përputhje me

1 atë çfarë ju kujtohet juve lidhur me këtë temë, Dëshmitar?

2 PË. Besoj që po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më tej ju thoni, se mënyra
4 sesi e kuptoni ju, në aspektin hierarkik, Ministria e
5 Mbrojtjes, si një prej ministrive përbërëse të qeverisë, do i
6 ketë raportuar më tej kryeministrit, a është e saktë kjo?

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Më duhet t'ju korrigjoj. Ai nuk
8 tha që "do ketë qenë" po "duhet të ketë qenë".

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për t'ju përgjigjur asaj
10 çfarë tha z. Misetiç, më lejoni të them dhe një herë, t'ju
11 bëj pyetjen.

12 Mënyrën se si ju e keni e keni kuptuar situatën, në
13 aspektin hierarkik, i takon që ministri i mbrojtjes duhet që
14 t'i kishte raportuar instancës më të lartë që në këtë rast
15 ishte kryeministri, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

16 PË. Sipas hierarkisë, besoj që është e saktë.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

18 Do t'ju pyes tani lidhur me rolin tuaj në gardën
19 kombëtare. Nuk jam shumë i qartë lidhur me atë çfarë ka
20 ndodhur lidhur me këtë temë dhe çfarë keni bërë ju në këtë
21 strukturë. Atëherë së pari, ju jeni emëruar që të drejtonit
22 gardën kombëtare, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

23 PË. Po, e saktë.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na e tregoni së
25 pari se kush ju caktoi ju në këtë rol?

1 PË. Nga Qeveria e Përkohshme.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Qeveria e Përkohshme apo
3 dikush konkret brenda Qeverisë së Përkohshme?

4 PË. Derisa e pashë unë dje, unë asnjëherë s'e kam pa këtë që
5 jam emëru direkt. Se mu ma ka komentu përmes telefonit dhe
6 emërimi kishte qenë nga Qeveria e Përkohshme, domethënë, se
7 nga z. Thaçi. Po këtë vendim s'e kam pa asnjëherë, këtë
8 urdhnesë.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë ta marrim hap pas
10 hapi.

11 Rexhep Selimi kur u intervistua nga ZPS-ja - dhe për
12 procesverbal bëhet fjalën për provën 763.5, në faqen 13 - ju
13 bë kjo pyetje. A mund të na konfirmoni që kur ju jeni emëruar
14 si shef i gardës kombëtare, Rexhep Selimi ka qenë anëtar i
15 Qeverisë së Përkohshme, a e konfirmoni këtë, Dëshmitar?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atij i bëhet pyetja:

18 "Kush e ka emëruar Sylejman Selimin si komandant të
19 gardës kombëtare?"

20 Përgjigja që ai jep është:

21 "Kryeministri."

22 A keni ndonjë arsye për ta kundërshtuar përgjigjen e z.
23 Rexhep Selimi lidhur me këtë pyetje?

24 PË. Jo, nuk kam arsye.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në fakt, sikurse e thatë

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 26

1 dhe vetë, juve ju tregua një vendim ose një dekret që ju
2 emëronte juve në atë post, a është e saktë kjo, domethënë,
3 ZPS-ja ua ka treguar një dokument të tillë?

4 PË. Po e saktë.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dekreti ishte nënshkruar
6 prej Hashim Thaçit në cilësinë e tij si kryeministër, a është
7 e saktë kjo?

8 PË. Po.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Më duhet t'ju kundërshtoj sepse ka
10 mungesë themelësie për këtë pyetje. Do ishte mirë ndoshta që
11 të tregohesh dokumenti dhe të tregohesh nënshkrimi i z. Thaçi.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të shohim provën
13 P112 në anglisht, ndërkohë versioni në shqip mban numrin P813.
14 Mendoj që për versionin në anglisht është faqja 3 e
15 dokumentit. Faleminderit. Mund të kalojmë dhe pak më poshtë në
16 faqe.

17 Atëherë së pari të shohim dekretin, që është dekreti
18 numër 84. Të presim derisa të shfaqet në ekran versioni në
19 shqip, z. Selimi.

20 Atëherë ju lutem shihni Dekretin numër 84/99 ku emërohet
21 z. Agim Çeku shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. A e
22 shikoni këtë, Dëshmitar?

23 PË. Po.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të zbresim pak më tej në
25 faqe, besoj që mund ta shihni që në të njëjtën datë është

1 lëshuar Dekreti numër 85. Ju lutem lexojeni pak.

2 Kalojmë tek faqja tjetër, në fillim të faqes.

3 Dëshmitar, a është ky dekreti që ju cakton ose ju emëron
4 juve si shefi i gardës kombëtare?

5 PË. Po, sipas kësaj është, po. Por unë asnjëherë s'e kam pa
6 as deri dje.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të konfirmoni se
8 dekreti i drejtohet kryeministrit Hashim Thaçi, domethënë,
9 është dekret i cili është lëshuar prej tij në emër të Qeveris
10 së Përkohshme të Kosovës si kryeministër i kësaj qeverie?

11 Pajtoheni me këtë?

12 PË. Po, saktë.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Lidhur me kundërshtimin që bëra më
14 herët, besoj që duhet ta kontrolloni në qoftë se dokumenti
15 ishte i nënshkruar apo jo.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju shpjeguat ose të paktën
17 unë e kuptova që ju shpjeguat -- ose jo, do t'jua bëj ndryshe
18 pyetjen se nuk jam shumë i qartë lidhur me atë çfarë thatë.

19 Garda kombëtare a është krijuar ndonjëherë? Domethënë, me
20 fjalë të tjera, a ka funksionuar realisht ndonjëherë garda
21 kombëtare apo nuk ka funksionuar asnjëherë?

22 PË. Deri në formimin e institucioneve, të flas për
23 institucionet deri në transformimin e prej UÇK-së në Trupat
24 Mbrojtëse të Kosovës, garda e Kosovës i ka -- nuk ka pas
25 detyra konkrete, po unë e kam udhëheq me një grup njerëzve për

1 detyrat ceremoniale.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më duhen më shumë hollësi
3 këtu. Çfarë stafi, çfarë personeli është dhënë ju në
4 dispozicion apo, me fjalë të tjera, sa veta kishit ju nën
5 veten, sa veta udhëhiqnit ju në rolin që kishit? Si drejtues i
6 gardës kombëtare, sa persona kishit në varësi?

7 PË. Në dikun 10 deri në 15 persona të cilët kanë qenë.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më konkretisht, çfarë keni
9 bërë? Domethënë, si drejtues i gardës kombëtare, konkretisht,
10 jo në teori, domethënë, na e thoni konkretisht, specifikisht
11 çfarë veprimtarish keni kryer?

12 PË. Kryesisht ne jemi përgatit me e pas një strukturë. Dhe
13 nuk kemi mujt me qit në letër derisa është, nuk e di në
14 ç'formë ose çfarë cilësie, çfarë numri, çfarë -- a do të jetë
15 gardë apo do të jetë një emër tjetër. Dhe, në këtë aspekt, nuk
16 kemi mujt me kry detyra ose funksione.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptojmë. Domethënë, i
18 takon që, në fakt, ju nuk është se keni kryer detyra
19 ceremoniale. Se ju nuk mund të jepni dot një shembull të vetëm
20 të një ceremonie ku keni marrë pjesë së bashku me gardën
21 kombëtare apo ka ndonjë rast të tillë dhe nuk e thatë?

22 PË. Jo, nuk ka ndonjë rast ceremonial që ne kemi marrë pjesë
23 se as nuk i kemi pas ende një rregullore apo një strukturë
24 sesi duket dhe jemi kanë në përgatitje e sipër. Ende nuk i
25 kemi dit se si do vjen struktura e ardhshme. Dhe kjo është

1 vendos më vonë në kuadër të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, ka
2 hi në strukturë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kujt i raportoni ju si
4 shef i gardës kombëtare në qoftë se i raportoni ndokujt,
5 domethënë, kërkoj kishit epror ju, kujt i raportoni lidhur me
6 veprimtaritë e kryera si shef i gardës kombëtare?

7 PË. Agim Çekut, si shef i shtabit.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sa shpesh i raportoni ju
9 atij lidhur me këtë veprimtari?

10 PË. Ne ishim, ne ishim të përditshëm, domethënë, duke bisedu
11 rreth strukturimit, rreth demobilizimit dhe ne për çdo herë
12 kemi qenë bashkë ose kontakte ditore.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përpara një çasti pamë
14 dekretin, në qoftë se është e nevojshme do t'i kthejmë përsëri
15 dekretit, pra, pamë dekretin që Agim Çeku emërohej si shef i
16 Shtabit të Përgjithshëm. A ju kujtohet dokumenti që patë për
17 një minute, Dëshmitar?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet, besoj e
20 diskutuat dhe ose pardje, por a ju kujtohet rasti kur z.
21 Misetic ju pyeti kush e ka emëruar z. Çeku dhe a ju kujtohet
22 që ai ju tregoi pjesë të intervistës së Çeku lidhur me këtë
23 temë. Ju kujtohen këto pyetje që ju bëri Misetic?

24 PË. Po.

25 PY. Në atë intervistë, z. Çeku thuhet që pretendon se emërimi

1 i tij ishte bërë nga Shtabi i Përgjithshëm. A ju kujtohet kjo
2 pjesa?

3 PË. Po.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, të supozojmë për një
5 çast që z. Çeku po tregon të vërtetën këtu dhe që
6 procesverbali i intervistës së tij është i saktë, ju besoj që
7 pajtoheni që anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm ose personat
8 që kishin kontakte më të, duhet të kenë qenë në gjendje të
9 dinin se kush e ka emëruar atë në atë post në atë pozitë. A
10 pajtoheni me mua?

11 PË. Po.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Edhe Rexhep Selimit i
13 bëhet kjo pyetje. Për procesverbal kjo pasqyrohet në P763.3,
14 në faqen 13, më konkretisht pyetja që i bëhet është kjo:

15 "Kush e ka caktuar Agim Çekun si shef të Shtabit të
16 Përgjithshëm të UÇK-së?"

17 Përgjigja që ai jep është:

18 "Kryeministri."

19 Po ashtu edhe Bislum Zyrapit i bëhet e njëjta pyetje. Kjo
20 për procesverbal jepet në P1355 Pjesa 11, faqja 20 dhe 21

21 "PY. Që të jemi të qartë, Agim Çekun a e ka emëruar
22 Hashim Thaçi?

23 "PË. Po, më vonë, po."

24 Më tej ai thotë:

25 "Po. Po, sepse kryeministri i asaj kohe i ka bërë

1 zëvendësimet, pra, mua më ka zëvendësuar me Agim Çekun.”

2 A keni ndonjë arsye për të kontestuar dëshmitë e Rexhep
3 Selimit dhe Bislim Zyrapit lidhur me këtë temë?

4 PË. Jo.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A pajtoheni me sugjerimin
6 se deklarata e tyre është në pajtim me përmbajtjen e dekretit
7 që pamë përpara pak kohe?

8 PË. Të dyjat lidhen njëkohësisht, po.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju pyes lidhur me dy
10 tema të vogla të cilat i keni diskutuar me avokatët. Së pari,
11 dua që të diskutojmë për Ferat Shalën.

12 Ju thatë që Ferat Shala në një pikë të caktuar kohe kaloi
13 nga njësitë Pëllumbi në Shtabin e Përgjithshëm. A ju kujtohet
14 ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

15 PË. Po, e saktë.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet të keni
17 pasur ndonjë kontakt me Ferat Shalën pas majit të vitit 1998?

18 PË. Nuk më kujtohet.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet ta keni parë
20 z. Ferat Shala në zonën e Drenicës pas majit të 1998?

21 PË. Nuk më kujtohet.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju thatë se nuk e dinit se
23 çfarë posti kishte marrë ai në Shtabin e Përgjithshëm pasi u
24 largua nga njësitë Pëllumbi. Po drejtorinë në të cilën ai ka
25 punuar në kohë në Shtabin e Përgjithshëm, a dini, pra, në

1 çfarë drejtorie ka punuar ai, keni informacion lidhur me këtë?

2 PË. Nuk pas informacione. Nuk kam njohuri.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur në mes ose në fund të
4 shkurtit të 1999, atëherë kur u bëtë komandant i përgjithshëm
5 i UÇK-së, a bëtë ndonjë pyetje se çfarë roli mori ai ose a
6 patë ose a morët ndonjë informacion se lidhur me çfarë
7 pozicioni kishte marrë ai, çfarë drejtuesi i çfarë drejtorie i
8 ishte apo ku ishte caktuar përderisa i takonte që të ishte nën
9 komandën tuaj?

10 PË. Jo, s'jam interesu asnjëherë, për të dhe nuk e di.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, kush i drejtonte
12 drejtoritë nën komandën tuaj, po thoni që në atë kohë, pra, në
13 shkurt të 1999, ju nuk keni marrë asnjë informacion, nuk dinit
14 fare se kush i drejtonte drejtoritë që ishin nën komandën
15 tuaj, për shembull, kush ishte pjesë e drejtorisë së zbulim
16 kundërzbulimit, kush ishte zëvendës, kush ishte shefi, pra,
17 kush ishte zëvendësi, nuk keni pas asnjë informacion?

18 PË. Jo, kemi pas disa informacione, po jo të detajizume për
19 arsye se nuk -- kam nejt në Drenicë dhe nuk jam merr shumë. Po
20 unë e kam dit që drejtori i G2 ka qenë z. Veseli, po ky nuk ka
21 qenë ose për z. Shala nuk e di çfarë ka pas në kuadër.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po pas luftës e morët këtë
23 informacion, domethënë, kur filluat që të ndërvepronit me
24 subjekte të tjera, a e morët vesh, a morët informacion se
25 çfarë ka bërë konkretisht z. Shala apo nuk e morët vesh

1 asnjëherë?

2 PË. Jo, s'jam merr me z. Shala. Dhe s'e di. S'më kujtohet.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
4 bëjmë pushim për dhjetë minuta tani. Ju lutem mos e diskutoni
5 dëshmi tuaj me askënd jashtë sallës së gjyqit. Mund të dilni
6 nga salla së bashku me Sekretaren.

7 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
9 pushim për dhjetë minuta.

10 --- Seanca ndërpritet në orën 10.02

11 --- Seanca rifillon në orën 10.13

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
13 sillni dëshmitarin.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Ndërkohë që presim që të vijë
15 dëshmitari --

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Dua të them diçka në fakt pa praninë
18 e dëshmitarit. Kemi disa pikëpyetje për pyetjet që u bënë në
19 fund lidhur me z. Shala.

20 Këto shqetësime i kemi shprehur dhe në dokumentin e
21 nëntorit të vitit të kaluar, më duket se është me numër
22 F02718, lidhur me masat që janë marrë për të garantuar
23 paanshmërinë e procesit gjyqësor.

24 Më lejoni ta përfundoj shkurtimisht këtë. Shqetësimi im
25 është ky, këto nuk janë pyetje sqaruese. Këto janë pyetje që

1 po i përdorni si bazë ju nga ana e Trupit Gjykues. Prandaj,
2 kjo është diçka që ne e kemi trajtuar në mocionin tonë.

3 Këto janë pyetje që mund t'i bëjë pala në pyetjet
4 plotësuese, këto nuk janë pyetje që duhet t'i bëjë Trupi
5 Gjykues. Edhe unë desha të dija a keni marrë ju ndonjë vendim
6 lidhur me mocionin tonë që është ende pezull.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

8 Z. DIXON: [Përkthim] Bëhet fjalë për mocionin e 13
9 nëntorit 2024, F02718.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vendimi im --
11 vendimi ynë është që do vazhdojmë me pyetjet në formën siç e
12 kemi bërë. Pyetjet lejohen nga rregullorja e procedurës, dhe
13 mund të bëjmë pyetje lidhur me çdo temë të mundshme.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Po unë po them që në mocionin tonë
15 ne kemi kërkuar që të garantohen dhe drejtat e të akuzuarve.
16 Edhe të garantohet paanshmëria dhe drejtësia e procesit
17 gjyqësor. Ne duam që kjo të merret parasysh. Unë po theksoj
18 dhe një herë që sot pyetjet nuk janë pyetje të paanshme. Këto
19 janë pyetje jo sqaruese nga ana e Gjykatësit, por janë pyetje
20 që po përdoren si bazë nga Gjykatësit për të dalë në
21 përfundimet e tyre.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

23 Z. DIXON: [Nuk ka përkthim].

24 I AKUZUARI VESELI: [E padëgjueshme].

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim].

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
2 sillni dëshmitarin.

3 [Dëshmitari vijon dëshminë]

4 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë, z.
6 Selimi, do të vazhdojmë me pyetjet e Trupit Gjykses.

7 Pyetje nga Trupi Gjykses: [Vazhdim]

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. Selimi,
9 për durimin tuaj. Jam thujse drejt fundit. Është dhe një temë
10 tjetër që dua të trajtoj me ju. Bëhet për fjalët - më falni -
11 për pyetjet që ju ka bërë z. Dixon, lidhur me z. Veseli.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni, më
13 falni, ju lutem, ju lutem mos flisni në sallën e gjyqit.
14 Faleminderit.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju shprehët vazhdimisht
16 pikëpamjen tuaj dhe thatë se ju nuk i keni besuar pretendimet
17 e Sabit Gecit kur thoshte ai se ishte pjesë e shërbimit të
18 zbulim-kundërzbulimit të UÇK-së. A e kam kuptuar unë këtë
19 drejtë?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në këtë kontekst, ju bëri
22 pyetje z. Dixon lidhur me një artikull që keni shkruar ju
23 personalisht i cili u botua tek Bota Sot. Ju kujtohet?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për procesverbal kjo është

1 prova P185.

2 Unë e kuptova kështu atë që i thatë ju z. Dixon për këtë
3 artikull, se ju donit që të dilte e vërteta juaj, versioni
4 juaj që të dëgjonte, ta mësonte publiku lidhur me akuzat që
5 diskutoni ju në atë artikull. Saktë?

6 PË. Po.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, nëse ju nuk i besonit
8 ato që ju thoshte ju z. Sabit Geci kur thoshte se ishte pjesë
9 e shërbimit të zbulimit, atëherë pse e përfshitë në një
10 artikull ku ju donit që të merrej vesh e vërteta?

11 PË. I kam referu asajna të cilët kanë ndodh edhe të cilin e
12 ka thënë z. Geci.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po. Por nëse ju thatë dhe
14 sikur e keni thënë vazhdimit edhe dje, që ju nuk e besonit
15 këtë version dhe donit që të merrej vesh e vërteta, pse e
16 përfshitë këtë në deklaratën tuaj?

17 PË. Nuk e di arsyen, por e kam përfshi atëherë në bazë të
18 deklaratë të cilën ma ka thënë edhe z. Geci.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. Selimi.
20 Kaq pyetje kisha unë për ju.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
22 Gaynor tani.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
24 Smith.

25 Dhe mirëmëngjes, Dëshmitar. Tema e parë që dua të trajtoj

1 unë janë marrjet në pyetje në Likovc. Në faqen 25002 të
2 transkriptit të 11 shkurtit, pra para dy ditësh, iu bë pyetje:

3 "A janë marrë në pyetje personat e arrestuar në Likovc?"

4 Ju jeni përgjigje dhe thatë:

5 "Nuk ka pasur të arrestuar për mendimin tim, po mund të
6 jenë marrë në pyetje persona, mund t'ju jenë bërë pyetje apo
7 diçka e kësaj natyre, po jo të arrestuar."

8 A ju kujtohet kjo përgjigje?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pyetja ime është kjo: Ku
11 janë marrë në pyetje këta persona?

12 PË. Ku janë ndalu në qoftë se në pika kontrolli, dhe në hyrje
13 ose dalje të Drenicës edhe dikund tjetër janë ndalu, janë në
14 marrë në pyetje, "Ku ke me shku?", ose për ne kur s'e ka njoft
15 një diçka të tillë, për qët arsye.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kush i kreu, kush e kreu
17 këtë procedurën e marrjes në pyetje?

18 PË. Ai kush ka qenë në atë pikë ai e ka marrë në pyetje.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ishte ushtar, ishte oficer i
20 policisë ushtarake?

21 PË. Pa marrë parasysh se çfarë detyrash ka, kur dikënd s'e ka
22 njoft ose një diçka, e ka marrë në pyetje [E pakuptueshme], e
23 ka [E pakuptueshme] me një fjalë.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kush ishte gjatë pyetjeve që
25 ta sqarojmë. Ishin kryesisht ushtarë apo ishin kryesisht

1 oficerë të policisë ushtarake?

2 PË. Besoj që ushtarë edhe me qellu të policisë, edhe të
3 policisë njëjtë. Por kryesisht ushtarë i cili ka qenë në atë
4 pikë.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Më 11 shkurt, ju keni thënë
6 po ashtu që:

7 "Policia ushtarake është marrë po ashtu me civilët ose
8 masat disiplinore lidhur me ushtarët."

9 A ju kujtohet kjo përgjigje?

10 PË. Po.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po çfarë çështje -- çfarë
12 çështje ishin këto që lidheshin me civilët që i trajtonte
13 policia ushtarake?

14 PË. Ishte kryesisht mbajtja e rendit në Likovc, për arsye se
15 ka pas shumë popullatë të ardhun dhe furnizimet ose detyrat
16 mjekësore me mbajtjen e rendit, në këtë qendër të Likovcit.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Besoj se na ke thënë në
18 faqen P2026, në faqen 43, se qëllimi i policisë ushtarake
19 ishte të përmirësonte disiplinën në ushtri. Saktë? Ju kujtohet
20 kjo?

21 PË. Ndoshta edhe këtë rol nganjëherë kanë -- është mundu që
22 me i majtë në disiplinë. Domethënë, edhe këtë rol ka mujt me e
23 lu, e ka lujt ose ka mujt me e lujt. Po, është e saktë.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, nëse roli i tyre ishte
25 përmirësimi i disiplinës në ushtri, pse merreshin me civilët?

1 PË. Sepse dhe civilët kishin nevojë, ka pas një grumbull të
2 njerëzve, ka pas një treg aty, po flas në kohën kur ka qenë
3 edhe ka pas për mbajtjen e rendit dhe të disiplinës aty për
4 ato kohë.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po pse ishte e nevojshme? A
6 mund të jeni pak më konkret, ju lutem?

7 PË. Ka pas ndoshta edhe ndonjë rast konfrontimit ose të
8 keqpërdorimit ose një diçka ato në qendrën e Likovcit ka pas
9 shumë njerëz të ardhun prej një fshatrave të tjera dhe në një
10 kohë të caktume ka pas edhe këtë detyrë, mbajtjen e rendit.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A ishit i shqetësuar ju për
12 praninë që mos -- mes -- mo -- më falni, në qoftë se kishte
13 persona mes popullatës civile që ndihmonte forcat serbe?
14 Shqetësoheshit për këtë?

15 PË. Jo. Në këtë kohë nuk ka pas -- ka pas të zhvendosur shumë
16 edhe iu ka afru ndihma prej kryesisht gati prej policisë
17 ushtarake që kanë pas nevojë, por jo në këtë aspekt të marrjes
18 në pyetje ose të hulumtimit.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A ju shqetësonte ju? A ishte
20 një shqetësim për ju mos kishte mes civilëve persona që
21 ndihmonin forcat serbe?

22 PË. Në këtë rast nuk e kam pas këtë shqetësim. Shqetësimi
23 ishte shumë më i madh, ishin duke mbush plot forcat serbe me
24 armatime me tankse, kishte granatime, kishte edhe popullata
25 ishte grumbullu në -- rreth Likovcit, në Likovc. Dhe në çdo

1 aspekt janë mundu me i dhënë ndihmën me i orientu dhe ja dhënë
2 ndihmën popullatës civile.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në faqen 43 të provës P2026,
4 ju është bërë pyetje:

5 "A keni krijuar policinë ushtarake në zonën tuaj kur
6 krijuar brigadat?"

7 Ju keni thënë:

8 "Me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm me qëllim që ... të
9 përmirësohej disiplina. Ekzistonte një ekip ... në çdo brigadë
10 që përbëhej nga pesë, gjashtë ... shtatë, apo dhe tetë
11 personash, që ishte në vartësinë e brigadës. Shtabin e kishin
12 ... në Likovc, pranë Shtabit të Përgjithshëm të zonës."

13 Të kujtohet kjo përgjigje?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kur e keni marrë ju këtë
16 urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm?

17 PË. Policinë ushtarake është -- është vendos nga komandanti i
18 zonës. Propozimet janë shku në Shtab të Përgjithshëm.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po, por si e kam kuptuar unë
20 përgjigjen tuaj në intervistë ishte që ju e keni krijuar
21 policinë ushtarake me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm.

22 Kështu e kam kuptuar unë. Dhe unë po ju pyes kur e keni marrë
23 ju këtë urdhër?

24 PË. S'ëm kujtohet që e kam marrë këtë urdhër. Nuk më
25 kujtohet.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua të sqarojmë diçka. Kodi
2 thirrës që kishit ju me numër 101, këtë kod kush jua caktoi
3 ju?

4 PË. Shumica ja kemi caktu vetvetes këto janë shifrat. Unë i
5 kam përcaktu duke u nis prej meje në zonë operative dhe duke u
6 thirr ma shumë në -- edhe shifra të tjera në -- qysh i kemi
7 pas edhe të mëhershme si njësite guerile dhe në atë formë kemi
8 caktu dhe vetë shifrat. Unë kam -- vetë e kam marrë 101 duke e
9 pa që numri i përshtatshëm për mu.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Besoj se e pamë në një
11 dokument më herët që ka patur shifra të ndryshme. Po duhet të
12 ketë qenë një person që caktonte cila shifër i caktohet cilit
13 person, apo jo?

14 PË. Jo. Ma shumë shifrat i kemi caktu vetvetes -- në bazë të
15 atyne shifrave tani kanë marrë dhe të tjerët. Pse shifra --
16 shifrat secili ja kemi caktu vetvetes. Unë, për shembull, ja
17 kam caktu 101 vendit.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Flasim tani për pozitën e
19 Kadri Veselit si shef i zbulimit apo -- si shef i zbulimit
20 brenda Shtabit të Përgjithshëm përpara se të formohej SHIK-u.
21 Ju thatë që keni pasur dijeni se ai ka qenë shefi i zbulimit.
22 Pyetja ime është kjo: Kur e keni mësuar ju që Kadri Veseli ka
23 qenë shefi i zbulimit pranë Shtabit të Përgjithshëm?

24 PË. Dikun kur unë e kam marrë detyrën si komandant i Shtabit
25 të Përgjithshëm.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po më duket se ju u pajtuat
2 më herët dhe thatë që e keni ditur që ka qenë shefi i G-2-shit
3 dikun nga 1998. Unë tani po përpigem ta kuptoj kur e keni
4 mësuar ju këtë?

5 PË. Nuk e di saktësisht, por dikund kah fundi '98-s ose
6 fillimi i '99-s. Nuk jam i saktë, nuk e di.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Si e mësove që ishte shefi i
8 zbulimit pranë Shtabit të Përgjithshëm?

9 PË. Unë e kam mësuar kur unë jam zgjedh komandant i Shtabit të
10 Përgjithshëm, struktura të cilat kanë ekzistuar.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua të sqaroj një çështje
12 gjuhësore mbase.

13 I lutem Sekretarisë të nxjerrë në ekran provën 1D00070.

14 Ky është një dokument që ju e keni parë dhe më herët. z.
15 Dëshmitar, ju e kuptoni pak anglishten, apo jo, apo e flisni
16 pak anglishten.

17 PË. Po, e kuptoj.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ky dokument ka dalë më 2
19 prill 1999. Duam të sqarojmë pak përkthimin këtu. Shikoni ju
20 lutem ministrin e informimit publik. Është pika 1. Domethënë
21 është "E Informimit Publik" në shqip. E shihni këtë "E
22 Informimit Publik"?

23 PË. Po.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shikoni pikën 6 tani. Pamë
25 1, tani të shkojmë 6. "Ministri i Shërbimit Informativ të

1 Kosovës".

2 PËRKTHYESJA: Gjykatësi po e lexon në shqip tekstin,
3 "Shërbimit Informativ të Kosovës".

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Saktë?

5 PË. Po, saktë.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] E pranoni që është përkthyer
7 saktë në anglisht kur thotë "*Kosovo Intelligent Service*",
8 "Shërbimi i Inteligjencës"? Mendoni se është përkthim i saktë?

9 PË. Jo, besoj që nuk është e saktë. Ministri i Shërbimit
10 Informativ - kurse 6 është *Ministër for Intelligence Service*.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po atëherë çfarë duhet të
12 kishte qenë? Çfarë është?

13 PË. Atëherë është dashtë sipas shqipes është dashtë me kon
14 Ministër i Inteligjencës -- dhe Shërbimi Informativ përshin
15 ndoshta dhe këtë. Po besoj që të dyja i përfshin, edhe
16 ministrin e *Intelligence Service*, edhe ministri i shërbimit
17 informativ.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mirë. Shprehja "Shërbimi
19 Informativ", a i përputhet akronimit SHIK? A është akronimi
20 SHIK?

21 PË. Inicialet e para, domethënë, Shërbimi Informativ i
22 Kosovës, shkurtesa SHIK.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] E njihni ju shërbimin -- e
24 njihnit Shërbimin Informativ të Shqipërisë ju në vitet '90, që
25 njihej po ashtu me akronimin SHIK, Shërbimi Informativ

1 Kombëtar? Nuk është në dokument, po ju pyes kështu në
2 përgjithësi. E njihnit Shërbimin Informativ Kombëtar të
3 Shqipërisë?

4 PË. Po, kam dëgju për [E pakuptueshme].

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A e dini se si e ka emrin
6 ky, kjo organizatë, kjo agjenci?

7 PË. Shërbimi Informativ Kombëtar i Shqipërisë.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit. Aty fjala
9 "Kombëtar" është e përfaqësuar, është e dhënë në shqip,
10 domethënë, që thuhet "Kombëtar", edhe kombëtar është i
11 pasqyruar tek akronimi SHIK, apo jo, Dëshmitar?

12 PË. Besoj që po, domethënë SHIK. Shërbimi Informativ
13 Kombëtar.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A e kam kuptuar drejt që
15 gjatë luftës në Kosovë shprehjet SHIK dhe ZKZ dhe G2 janë
16 përdorur në mënyrë informale dhe kanë pasur të njëjtën vlerë,
17 domethënë, njësoj janë përdorur për t'iu referuar shërbimit të
18 zbulim-kundërzbulimit të UÇK-së? A e kam kuptuar drejtë unë
19 këtë, Dëshmitar?

20 PË. Jo, nuk mund me qenë të njëjta. ZKZ është diçka tjetër.
21 Shërbimi Informativ është diçka tjetër. Zbulim dhe
22 kundërzbulim është, domethënë, kur ti ke një strukturë dhe ke
23 një njësi që e bën zbulimin dhe kundërzbulimin, një njësi që,
24 për vëzhgimin e forcave dhe mjeteve të cilat i ka armiku. Nuk
25 janë të njëjta, nuk, s'kanë qenë të njëjta.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mund të jetë kështu, por
2 përpara sesa të krijohej SHIK-u për Kosovën, Shërbimi
3 Informativ i UÇK-së njihej si ZKZ, a është kështu, Dëshmitar?
4 PË. Nuk mund ta them. Nuk, si shërbim informativ nuk mund ta
5 them që është i njëjti, sipas strukturës.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do jua bëj ndryshe pyetjen.
7 Zakonisht, kur ju i drejtoheshit shërbimit informativ gjatë
8 luftës në mënyrë informale, çfarë shprehje përdornit ju kur
9 diskutonit, për shembull, për çështje që kishin të bënin me
10 shërbimin informativ me persona të tjerë? Informalisht, çfarë
11 shprehje përdornit, çfarë emërtimi përdornit për këtë
12 strukturë?

13 PË. Nuk kemi përdor asnjë strukturë dhe asnji term, nuk e di
14 çfarë. "Shërbimi Informativ", nuk më kujtohet nga ajo që kemi
15 përdorur.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Gjatë dëshmive në këtë Trup,
17 përpara këtij Trupi Gjykses, ne kemi dëgjuar shumë versione.
18 Kemi dëgjuar për shembull G2, SHIK-un, ZKZ-në. Sa i takon
19 këtyre termave, a mund të na thoni kë keni përdorur juve për
20 t'iu drejtuar shërbimit informativ? Keni përdorur G2-in, SHIK-
21 un, ZKZ-në, gjatë luftës e kam fjalën?

22 PË. Rrethanat e luftës kanë qenë krejt ndryshe. Me rrethanat
23 e -- në atë kohë unë kam përdor zbulim dhe kundërzbulim. Varet
24 zona të tjera si e kanë përdor, unë e kam përdor këtë term.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do të vazhdoj me një temë

1 tjetër. Tema ka të bëjë me shprehjen e papëlqimit nga, ose
2 mospëlqimit, nga komandantët e zonave. Për personat në sallën
3 e gjyqit që duan të na ndjekin, e kam fjalë për faqen 2506 që
4 ka të bëjë me datën 11 shkurt. Ju thoni, dhe këtu citoj:

5 "Është e saktë që si komandantë zone ne kishim shqetësime
6 dhe pakënaqësi, edhe unë vetë kam dhënë mendime të ndryshme
7 dhe kam dhënë, kam shfaqur shqetësime të ndryshme, ashtu siç
8 edhe komandantët e tjerë të zonave. Dhe të gjitha ato kishin
9 të bënin me përmirësimin e funksionimit."

10 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

11 PË. Po.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A ka ndodhur që ju shpesh
13 t'ia shprehnit pakënaqësinë tuaj Shtabit të Përgjithshëm?

14 PË. Pakënaqësi kam pas shpeshherë me Shtabin e Përgjithshëm.
15 Tashmë jemi sqaru edhe ma gjanësisht arsyet pse.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po, ju lutem, sqarojeni. Na
17 thoni gjithashtu që kujt në Shtabin e Përgjithshëm ia keni
18 shprehur këto shqetësime.

19 PË. Unë e kam shpreh shqetësimet në këtë takim, por në kohë
20 lufte dhe në kohë tash na po flasim për një term të madh,
21 "Shtabi i Përgjithshëm", edhe po më duket, i duket si në kohë
22 paqe është një objekt i madh, është me njerëz shumë. Me një
23 infrastrukturë që, është i, me shumë njerëz. Kurse ne në këtë
24 kohë kur po flasim, po flasim për një Shtab të Përgjithshëm,
25 thuaj gati inekzistent, me pak njerëz, me, i paorganizum. Sa

1 herë ne kemi pas një nevojë ose një kërkesë ose një
2 mbështetje, si zonë ku me iu drejtu, nuk kemi pas mundësi të
3 mbështetjes, as në logjistike apo një, me operacione të
4 ndryshme. Me mungesë të armatimit, me mungesë të gjitha.

5 Me një Shtab të Përgjithshëm me disa anëtarë të cilët
6 ndoshta asnjherë s'i ke dit ku janë, as se ku, me një objekt,
7 një Shtab i Përgjithshëm, në një objekt ku, me shtëpi private,
8 me dy dhoma, tri dhoma. Kurse këto, domethënë, të gjitha kanë
9 qenë ankesa. Me njerëz jo, profesionalë ndoshta, të aspektit
10 ushtarak. Edhe të gjitha këto kanë qenë ato të cilat unë i kam
11 shpreh edhe disa herë, edhe ndaj individëve të caktum.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Për kë individ bëhet fjalë
13 konkretisht?

14 PË. Për shembull, ka qenë kundër, kam pas kritika
15 zëvendëskomandantit për operacione, ose edhe ndoshta edhe për
16 z. Krasniqi, krejt për arsye teknike, për arsye të cilat gjatë
17 kohës të luftës kanë qenë shumë për mu, ka qenë shumë evidente
18 që nuk kam pas mbështetje, ose nuk kam pas një plan
19 operacional, një plan për shembull si zëvendëskomandanti për
20 operacionet asnjherë s'e ke pas në terren që me, një ekip që
21 me, apo ku janë forcat armike, si të veprohet, si të mbështet
22 me një plan operacional apo me pajisje, me armatim. Si të
23 evakuoheshin civilët, ku me i sistemu, ça me ia pru. Të gjitha
24 këto duhet një shtab operacional ose një Shtab i Përgjithshëm,
25 do të duhet me i përgatit, me i pas, që të më mbështesin, si

1 zonë unë asnjëherë s'i kam pas.

2 Dhe çdo herë kur një komandant zonash merr vetë, merr
3 veprime dhe analizën e luftës dhe në përgjithësi me situatën
4 të cilën u ka kriju në ato momente. Dhe për këtë arsye disa
5 herë ia kam jap edhe vërejtjet e mia.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Me sa po kuptoj unë, është
7 që ju shprehjen e pakënaqësisë e shikonit si një mënyrë që
8 UÇK-ja të funksiononte më mirë. A është e saktë kjo?
9 PË. E saktë.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A e keni konsideruar
11 gjithashtu edhe shprehjen e mospëlqimit nga komandantët e
12 zonave që të ishte mungesë varësie? Domethënë, një lloj
13 rebelimi prej tyre për të mos qenë në varësi?

14 PË. Secili komandant i ka pas nevojat e veta dhe kritikën
15 ndaj, ndoshta ndaj, Shtabit të Përgjithshëm. Ndaj njerëzve,
16 ndaj Shtabit të Përgjithshëm. Edhe secili komandant ka qenë i
17 pavarur në vendimet e tijna me varësisht prej terrenit dhe
18 rrethanave të cilat i ka pas në zonë.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Atëherë, kalojmë tek arsyeja
20 kryesore se pse disa komandantë zonash nuk u pajtuan me
21 draftin fillestar, ose draftin e parë të marrëveshjes së
22 Rambujesë. Ju keni thënë, nuk e kam faqen konkrete këtu,
23 megjithatë e keni thënë më datë 11 shkurt, dhe këtu citoj:

24 "Drafti përfshinte një dispozitë që forcat serbe nuk do
25 të largoheshin nga territori, nuk do të tërhiqeshin, dhe ne

1 duhej që të çarmatoseshim. Kjo do të thoshte që ne duhet të
2 dorëzonim armët, ndërkohë që forcat serbe do të vazhdonin të
3 qëndronin në Kosovë.”

4 A ju kujtohet ta keni thënë këtë?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, si komandant ushtarak,
7 mbase nuk është tërësisht befasuese që ju ishit të shqetësuar
8 lidhur me mundësinë që mund të çarmatoseshit fare ndërkohë që
9 forcat armike të qëndronin, të vazhdonin të qëndronin në
10 territorin tuaj, dhe të vazhdonin që të ishin të armatosura? A
11 është kjo një përmbledhje e drejtë e shqetësimit tuaj?

12 PË. Po, saktë. Edhe në këtë tekst asnjëherë s'është parapa që
13 të, pavarësia e Kosovës. Domethënë, teksti i parë kur është
14 pa, ka qenë shumë i pafavorshëm për mendimin tim në atë kohë.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A e keni konsideruar
16 shprehjen e mospëlqimit nga komandantët e zonave lidhur me
17 këto dy pika që të ishte një lloj trajte rebelimi për
18 mosvarësi, ose mosbindje?

19 PË. Nëse ne e kemi shpreh mendimin tonë, nëse faktikisht nuk
20 është merr edhe mendimi jonë, ka qenë e vështirë që
21 delegacioni të merr vendime për arsye se të gjithë komandantët
22 e zonave kanë pas përgjegjësinë dhe kanë pas terrenin. Nuk
23 mund të them që ka qenë një rebelim, por ka qenë ma shumë një
24 sugjerim, ose një qëndresë.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A e keni konsideruar

1 shprehjen rastësore të mospëlqimit të komandantëve të zona si
2 diçka që e forconte apo e dobësonte strukturat e komandës
3 brenda UÇK-së, si i keni menduar këto pakënaqësi?
4 PË. Unë mendoj që e kanë forcu, jo që e kanë dobësu. E kanë
5 forcu edhe delegacionin i cili ka qenë atje.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani do të kaloj tek procesi
7 i konsultimit lidhur me emërimet brenda UÇK-së, përfshirë këtu
8 edhe Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së.

9 Në faqen 25058, juve ju bëhet kjo pyetje:

10 "... a besonit ju që një komandant zone duhej që të
11 konsultohej sa i takon emërimeve në Shtabin e Përgjithshëm?"

12 Përgjigjja që ju jepni është:

13 "... po, ne, mendoj që ne duhet të ishim konsultuar në
14 mënyrë të tillë që organizata të ishte më e mirë dhe më e
15 suksesshme në përgjithësi."

16 Dhe pastaj kur u pyetët se pse, ju thatë:

17 "Sepse komandantët e zonave ishin persona që kishin
18 përgjegjësi në terren."

19 Vazhduat më tej dhe thatë:

20 "Do kishte qenë e rëndësishme për organizatën dhe për të
21 gjithë strukturën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të
22 Shtabit të Përgjithshëm, në veçanti, nëse do ishte bërë një
23 konsultim i tillë."

24 A ju kujtohet të keni dhënë këto përgjigje, Dëshmitar?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Le të shtjellojmë pak në më
2 tepër hollësi shpjegimin, shpjegimet që jepni ju. A mund të na
3 thoni se pse ishte praktikë e mirë që komandantët e zonave të
4 konsultoheshin për sa i takon emërimeve, pra që Shtabi i
5 Përgjithshëm të konsultohet me komandantët e zonave? Pse
6 mendoni që kjo do kishte vlerë, ose do ishte e mirë për
7 funksionimin e përgjithshëm të UÇK-së, çfarë vlere do të
8 sillte kjo?

9 PË. Besoj se komandantët e zonave ma mirë e kanë njoft dhe
10 terrenin edhe situatën të cilën e kanë pas në terren. Edhe
11 njerëz të cilët kanë, i kanë njoft. Dhe se në këtë aspekt ma
12 mirë kishte me qenë. Në këtë fazë, kështu e kam mendu.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ky proces konsultimi, a ka
14 çuar në një pranim më të madh të komandantëve të zonës të
15 autoritetit ose të kompetencave që kishte Shtabi i
16 Përgjithshëm?

17 PË. Komandantët e zonave e kanë pas kompetencën gjithmonë dhe
18 hapësirën ku ka vepru, e ka pas kompetencën komandanti i
19 zonës.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pyetja ime ka të bëjë me
21 procesin e konsultimit, ajo çfarë po pyes unë është kjo që,
22 fakti që, për shembull, ju iu merrej opinioni ose mendimi, një
23 gjë e tillë a do të rriste mundësinë ose shanset që juve të
24 pranoni personat që do të pranoheshin ose do të emëroheshin
25 në Shtabin e Përgjithshëm?

1 PË. Besoj që kishte me qenë një organizim ma i mirë, edhe ma
2 i suksesshëm.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Të kalojmë te diçka që keni
4 thënë në intervistën për gazetën Zëri, që është prova P01745,
5 në faqen 23 të versionit në anglisht.

6 Ju po diskutonit lidhur me periudhën rreth kulminimit të
7 ofensivës serbe. Ju bë pyetje lidhur me praninë e Hashim
8 Thaçit në zonën e Drenicës. Dhe ju thatë, citoj këtu:

9 "Hashim Thaçi kishte ardhur për të mbajtur kontakte me
10 komandantët e zonave, që të fliste me ne lidhur me situatën në
11 përgjithësi dhe nevojat tona. Ne ishim ata që po drejtonim
12 luftën. Prania e Hashimit ishte shumë e rëndësishme për
13 moralin. Ai ishte shumë i qetë gjatë luftës, ai nuk ishte fare
14 i frikësuar."

15 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

16 PË. Në intervistë e ke fjalën? Mua s'më kujtohet, s'e kam pa
17 as më përpara.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po, për intervistën e kam
19 fjalën. Po, e lexova nga intervista juaj. Dua të përqendrohem
20 te vizita ose vizitat e tij në qendrën e trajnimit, ose në
21 zonën e Drenicës. Ka bërë një vizitë ai, apo ka bërë disa
22 vizita? Kjo është pyetja e parë.

23 PË. Nuk më kujtohet sa vizita i ka pas, ose. Mu më kujtohet
24 që një herë a dy e kam taku z. Thaçi, jo ma shumë.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kur jeni takuar me të, a i

1 keni shprehur atij shqetësimet për të cilat sapo na folët, na
2 folët përpara pak çastesh? Domethënë, mungesa e armëve,
3 mungesa e municioneve, mungesa e planifikimit të duhur, këto
4 shqetësime, a ia keni shprehur atij kur jeni takuar me të?
5 PË. Nuk e di. Z. Thaçi në atë kohë ka pas çështjen e
6 informimit ma shumë politik, ma shumë me këto çështje. Nuk e
7 di që e kam bisedu, ma shumë për çështje të organizimit të
8 brendshëm dhe jam konsultu me njerëzit e mi dhe me njerëz të
9 cilët jam mundu të rregulloj ma mirë situatën të cilën e kam
10 [E pakuptueshme]. Nuk më kujtohet ndonjë bisedë konkrete që
11 kam pas me z. Thaçi.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Por në kohën e këtyre
13 ofensivave kaq shumë të rënda serbe, juve po përdornit shumë
14 municion, apo jo, Dëshmitar?

15 PË. Po.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A nuk kishit frikë që mund
17 t'ju mbaronte municioni? Se kam përshtypjen që e keni thënë
18 dhe më herët, që ishit shqetësuar që ndoshta nuk do të kishit
19 municion të mjaftueshëm, ose ishit të shqetësuar lidhur me
20 cilësinë e armëve, apo jo?

21 PË. Po shumë shpesh ne kemi pas mungesë të armëve, por nuk më
22 kujtohet një bisedë e tillë që e kam ba me z. Thaçi. Ajo është
23 parë.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera për
25 ju, Dëshmitar. Faleminderit shumë për vëmendjen.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka pyetje
2 Prokuroria?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Shumë shkurtimisht kam disa
4 pyetje. Shpresoj që do të përfundoj deri në orën 11.00.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
6 Përpara se sa t'ju jap fjalën juve, dua t'ju pyes ekipet e
7 Mbrojtjes në qoftë se do kenë pyetje ekipet e Mbrojtjes.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Do më duhet rreth një orë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
10 Atëherë do vazhdojmë me Halling, pastaj do bëjmë pushimin dhe
11 do vazhdojmë me z. Misetic.

12 Pyetje vijuese të mëtejshme nga z. Halling:

13 Z. HALLING: [Përkthim]

14 PY. Dëshmitar, dua t'ju bëj një pyetje lidhur me përgjigjen
15 që sapo i thatë, Dëshmitar, Gjykatësit Gaynor. Ishte faqja 33
16 e transkriptit në kohë reale. Pyetja që bëri Gjykatësi Gaynor
17 ishte në qoftë se keni pasur shqetësime që kishte civilë që i
18 ndihmonin forcat serbe. Dhe në përgjigje të pyetjes ju thatë,
19 "Jo", nuk ishit i shqetësuar lidhur me këtë.

20 A ju kujtohet kjo përgjigje e sapo dhënë, Dëshmitar?

21 PË. Po, e saktë.

22 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretares të paraqesë në
23 ekran provën P115 në shqip dhe në anglisht. Ky është një
24 dokument i cili është dokumenti i parë në listën e dokumenteve
25 të ZPS-së.

1 PY. Sa për kontekst, Dëshmitar, më datë 5 shkurt 1999, a mund
2 të na thoni a keni qenë akoma komandant i zonës së Drenicës në
3 atë kohë?

4 PË. 5 shkurt? Besoj që po.

5 PY. Po, më 5 shkurt.

6 PË. Po.

7 PY. Sikurse mund ta shikoni në fillim të faqes, thuhet 5
8 shkurt 1999. Thuhet më tej që është "Radio Kosova e Lirë":

9 "Komunikatë e komandës së zonës operative të Drenicës."

10 Do t'ju lexoj fillimin e kësaj komunikate:

11 "Komanda e zonës operative të Drenicës u bën thirrje dhe
12 i obligon të gjithë qytetarët e komunave Glogovc, Klinë dhe
13 Skenderaj që urgjentisht t'i ndërpresim të gjitha veprimtaritë
14 që e ndihmojnë armikun. Veçanërisht kërkon që të mos u
15 nënshtrohemi interesave të ngushta personale siç është
16 rregullimi i dokumentacionit personal në administratën serbe."

17 Dëshmitar, këtu flitet për ndërprerjen e veprimtarive të
18 qytetarëve, që e ndihmojnë armikun, dhe pavarësisht kësaj që
19 është shkruar këtu, ju vazhdoni që të thoni që në zonën tuaj
20 ju nuk është se ishit të shqetësuar që civilët mund të
21 ndihmonin okupatorin, ose armikun.

22 PË. Fola për në Likovc, fola për çështjen e popullatës civile
23 e cila ka qenë në Likovc. Edhe policia ushtarake ka mbajtur
24 këtë rend. Edhe pyetja që, a është, a keni qenë të shqetësuar
25 që ka pas, domethënë, informatorë në, ose kam pas këtë

1 shqetësim.

2 PY. Në qoftë se nuk e kishit këtë shqetësim, pse është
3 lëshuar një komunikatë nga zona juaj duke u bërë thirrje të
4 gjithë qytetarëve që të ndërprisnin të gjitha veprimet që e
5 ndihmonin armikun?

6 PË. Kanë pas, edhe kur është lëshu kjo ndoshta në rrethana të
7 tjera, unë nuk po i di, edhe kush e ka lëshu atë. Por
8 shqetësimi normal që ka qenë, nuk po them që nuk ka qenë
9 shqetësimi i njerëzve të cilët kanë informu ose kanë
10 bashkëpunu në këtë kohë me Serbinë, por unë iu përgjigja
11 konkretisht pyetjes së parë, për gjendjen e policisë ushtarake
12 në Likovc.

13 PY. Në përgjigjen e fundit, thatë që ju nuk e dinit se kush e
14 ka lëshuar këtë, mbase mund t'ju ndihmoj unë lidhur me këtë.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të kalojmë
16 te faqja tjetër e këtij dokumenti.

17 PY. Komunikata përfundon kështu:

18 "Nuk duhet të krijohet përshtypja nga asnjë veprim, nga
19 ana e qytetarëve që pushteti okupues njihet në çfarëdo lloj
20 mënyre. Është e papranueshme dhe e dënueshme që të kërkohet
21 çfarëdo lloj ndihme prej atyre që vrasin gra, pleq e fëmijë,
22 thuhet në komunikatën e komandës së zonës operative të
23 Drenicës e nënshkruar prej Sylejman Selimit, komandant i
24 zonës."

25 Atëherë, i takon që keni qenë ju, Dëshmitar, personi që e

1 ka lëshuar këtë komunikatë?

2 PË. Po. Po, e saktë.

3 Nuk kam pyetje të tjera.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
5 pushim për 30 minuta tani.

6 Dëshmitar, ju lutem mos diskutoni me askënd lidhur me
7 dëshminë tuaj jashtë sallës së gjyqit.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 --- Pauza fillon në orën 11.00

10 --- Seanca rifillon në orën 11.31

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Halling,
12 ju lutem na thoni pak për dëshmitarët e javës tjetër. S'kemi
13 asnjë informacion aktualisht ose pothuajse fare informacion,
14 do duhet të përgatitemi.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Fatkeqësisht, nuk mund t'ju jap
16 shumë informacion tani. Kemi pasur një problem me dëshmitarin
17 që është parashikuar për javën tjetër dhe ky dëshmitar nuk
18 vjen dot deri në javën e fundit të shkurtit. Jemi përpjekur të
19 gjejmë një dëshmitar tjetër, por për momentin s'kemi mundur,
20 kështu që vetëm një dëshmitar për momentin. Edhe dëshmitari i
21 vetëm që ne kemi është 04491.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e kuptoni
23 që kjo ju ndikon në kohën tuaj?

24 Z. HALLING: [Përkthim] E dimë që na ndikon në kohën tonë.
25 Po nuk kemi dëshmitar për ta zëvendësuar.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uroj që ta
2 gjeni një person dhe na thoni, na thoni sa më shpejt. Gjeni
3 një zëvendësues ju lutem dhe na njoftoni.

4 Silleni dëshmitarin në sallë.

5 [Dëshmitari vijon dëshminë]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
7 kemi ende disa pyetje, Ekipet e Mbrojtjes kanë disa pyetje
8 plotësuese që burojnë nga pyetjet e Gjykatësve, është pjesë e
9 procesit kjo.

10 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç:

11 Z. MISETIC: [Përkthim]

12 PY. Mirëmëngjes, z. Selimi edhe një herë.

13 PË. Mirëmëngjes.

14 PY. Faleminderit. Dua të fillojmë me disa pyetje që ju bëri
15 Gjykatësi Mettraux për dekretet kinse të lëshuara nga Qeveria
16 e Përkohshme e Kosovës më 28 prill 1999, ku pretendohet që
17 është emëruar gjeneral Çeku si komandant i përgjithshëm. Ju
18 kujtohen pyetjet e Gjykatësi Mettraux?

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shef shtabi thashë.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Korrigjoj veten.

21 PY. Shef shtabi.

22 PË. Po.

23 PY. Ju kujtohet pyetja?

24 PË. Po.

25 PY. A i vutë re që dekretet nuk kishin asnjë nënshkrim?

1 PË. Po, e pash.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetic, më falni që po
3 ju ndërpres, ngritët këtë edhe kur e bëra unë pyetjen, nëse
4 kanë nënshkrime apo jo këto dekrete, unë s'e di tani si e
5 kuptoni ju nënshkrimin. Por ju lutem, shohim provën P113, që
6 keni përdorur ju të martën dhe, më duket se të martën, në
7 faqen 35075, ku thuhet se kjo hyn në fuqi dhe ka qenë e
8 nënshkruar nga kryeministri Hashim Thaçi.

9 Pra, mbase kjo do ju ndihmonte ta përcaktojmë çfarë është
10 e çfarë nuk është një nënshkrim se unë nuk e kam të qartë.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Ja më jepni një çast ta vendosim
12 dokumentin në ekran atëherë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse ju ndihmon është
14 arkiva e radios Kosova e Lirë, aty mund ta gjenin dokumentin
15 domethënë. Është me ERN 008557-0008560-ET. Më duket se dhe ju
16 vetë e përdorët këtë dhe mori numrin 25075.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Po. E kemi përdorur dhe ne këtë
18 dokument. Mund ta gjeni dhe në listën tonë të materialeve.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë po ju them që pretendohet se
20 ka një dokument të nënshkruar dhe unë po ju them që s'ka
21 dokument të nënshkruar.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po si e kuptoni ju
23 nënshkrimin pra, dëshmia thotë këtu -- s'jam i sigurtë për
24 çfarë po flasim.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Më lejoni mua ta sqaroj. Ju po

1 thoni se ka fjalë se është i nënshkruar dokumenti, ky është
2 nënshkrimi i dokumentit.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po nënshkrimi nuk është
4 domosdoshmërisht një nënshkrim dore i emrit. Mund të ketë
5 nënshkrime në forma të ndryshme.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë po ju them dhe pretendimi
7 është që nuk ka as nënshkrim, as vulë dokumenti. Në dokumentet
8 zyrtare si rregull që kemi dhe të UÇK-së, duhet të ketë vulë e
9 nënshkrim. Këtë po përpiqen të sqaroj.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Vazhdoni atëherë.

11 Z. MISETIC: [Përkthim]

12 PY. Po e përsëris pyetjen atëherë. Z. Dëshmitar, a e patë që
13 dokumentet që ju patë, dekretet në fjalë nuk kishin nënshkrim,
14 tamam nënshkrim, në kuptimin e parë të fjalës?

15 PË. Po, ato i pamë.

16 PY. Dhe unë po ju them që kjo që keni parë ju ka ardhur nga
17 një libër që ka e botuar *Kosova Press* në vitin 2016 edhe nuk
18 ka pasur asnjë provë të mëparshme që këto dekrete të jenë
19 shpallur në 1999. A e kuptoni këtë pikë, ka dalë nga një
20 gazetë, pra, gazeta *Kosova Press*?

21 PË. Po, e kuptoj.

22 PY. Ju kujtohet data e këtij dekreti të pretenduar që është
23 28 prill 1999. Mbaheni këtë parasysh, ju lutem. Në pyetjet që
24 ju bëra unë të martën, rreshtat 2 deri 8 të transkriptit, ju
25 thatë që nuk ishit më komandant i përgjithshëm dy-tri ditë

1 para fillimit të bombardimeve të NATO-s, që i takon
2 përfaqësisht nga fundi i marsit, që nga ato momente nuk ishit
3 më komandant i përgjithshëm, saktë?

4 PË. Po, e saktë.

5 PY. UÇK-ja nuk ka qenë pa shef të Shtabit të Përgjithshëm apo
6 komandant të përgjithshëm që nga fundi i marsit e deri në
7 prill të 1999, apo jo, e ka pasur një komandant, apo jo?

8 PË. Po, ka qenë shefi i shtabit Agim Çeku.

9 PY. Po. Pra, Agim Çeku ka qenë shef i shtabit, po themi
10 përfaqësisht qysh nga fillimi i prillit mbase 1999, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Domethënë, dikush e ka emëruar atë në këtë pozitë përpara
13 se të dilte ky dekret i pretenduar i 28 prillit 1999, apo jo?

14 PË. Po, e saktë.

15 PY. Unë po ju them, unë ju thashë - më falni - ju tregova
16 gjatë pyetjeve të mia intervistën e gjeneral Çekut që e ka
17 dhënë në mars të vitit 2000, më pak se një vit pasi u bë shef
18 i Shtabit të Përgjithshëm, ku ka thënë se ka qenë i gjithë
19 Shtabi i Përgjithshëm që e emëroi atë.

20 A e pranoni ju përshkrimin që i jep ai emërimit të tij 11
21 muaj pas emërimit dhe a pranoni ju kur them unë që mënyra sesi
22 e përshkruan emërimin e tij ai, 11 muaj pasi kishte ndodhur
23 konkretisht, mund të jetë më i saktë se ajo që kujton Zyrapi
24 dhe Rexhep Selimi kur e dhanë dëshminë 20 vjet pasi ka ndodhur
25 ngjarja në fjalë në kontekstin e një procesi penal? Pra, e

1 pranoni këtë përshkrim timin?

2 PË. Nuk e di si e ka pas z. Çeku edhe nuk e di si ka shku
3 takimi. Nuk e di formën si, pasi e kam dorëzuar detyrën.

4 PY. Po. Po ju nuk e dinit, nuk dinit as ndonjë vendim emërimi
5 nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës siç pretendohet. Do t'ju
6 tregoj një dokument.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Do shohim dokumentin në origjinal
8 SPOE00346185 deri në SPOE00346197 në SPOE00346187 dhe
9 përkthimin anglisht, që e ka përgatitur Ekipi i Mbrojtjes së
10 Thaçit për këtë material, që është me numër DHT05002 deri në
11 DHT005002. 187, ju lutem.

12 PY. Do të shihni në ekran një dokument që ka një vulë:

13 "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së është për riorganizimin
14 dhe rrethanave të reja merr:

15 "Vendim:

16 "Agim Çeku emërohet shefi i Shtabit të Përgjithshëm të
17 UÇK-së. Kjo është detyrë ekuivalente me atë të komandantit të
18 përgjithshëm të UÇK-së deri në zgjedhjen e tij.

19 "Sylejman Selimi emërohet komandant i gardës kombëtare të
20 UÇK-së.

21 "Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

22 "Prill 1999, Kosovë."

23 Dhe ka vulën e Shtabit të Përgjithshëm. E shihni?

24 PË. Po.

25 PY. Tani, kjo e shpjegon se si është bërë shef i Shtabit të

1 Përgjithshëm gjeneral Çeku që nga fillimi i prillit 1999, ka
2 kuptim kjo, apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Ju vetë keni thënë se e keni mësuar emërimin tuaj bazuar
5 në atë që keni dëgjuar në televizion kur ju pyeta unë gjatë
6 pyetjeve të mia, kështu më thatë, e keni mësuar prej
7 televizionit? S'keni marrë ndonjë letër, ndonjë shkresë ku
8 emëroheshit, apo jo --

9 PË. E saktë është. E saktë.

10 PY. -- në gardën kombëtare?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë
12 kopje me nënshkrim?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Po kam kopje me vulë. Këtë e kemi
14 marrë nga ZPS-ja si dokument.

15 Kërkoj pranimin e këtij dokument si provë gjyqësore, ju
16 lutem.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
18 kundërshtime?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim, po të
20 pranohet vetëm kjo faqe.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Vetëm këtë faqe dua dhe unë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 85 ishte?

23 Z. MISETIC: [Përkthim] 87.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 87.

25 SPOE000346187 pranohet.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e
2 provës 1D249 dhe klasifikimin publik në Legal Workflow.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka problem për mua, nuk ka pse të
4 jetë konfidencial ai.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
6 Ky është një dokument publik.

7 Z. MISETIC: [Përkthim]
8 PY. Pyeti Gjykatësi Mettraux pasi ju tregoi një dokument të
9 26 majit të gjeneral Çekut ku i raporte ministrit të Mbrojtjes
10 Azem Sylës, pasi ua tregoi dokumentin ju bëri pyetje për
11 dëshminë tuaj, që sipas jush, z. Sylë duhet t'i kishte
12 raportuar kryeministrit, z. Thaçi. Ju kujtohet kjo?

13 PË. Po.

14 PY. Do të tregoj tani disa dokumente shtesë. Mbani parasysh
15 datën e raportit, ju lutem, që ka qenë 26 maj, që ka qenë
16 fillimi i Operacionit Shigjeta, faza e dytë, mbaje parasysh
17 këtë. E kupton?

18 PË. Po.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem tani Sekretarisë të shkojë
20 në listën tonë të materialeve dhe të nxjerrë në ekran provën
21 1D00206.

22 PY. Ky është një artikull gazete që tregon që ndërkohë që
23 kishte filluar Operacioni Shigjeta më 27 maj, z. Thaçi ka qenë
24 në Paris. E shihni? Kishte filluar Operacioni Shigjeta,
25 ndërkohë z. Thaçi ishte në Paris. E shihni?

1 PË. Po, e saktë.

2 PY. Nuk po ua tregoj të gjitha dokumentet, por po ua lexoj
3 por palët mund t'i shohin nëse i interesojnë. Në provën P05222
4 në dokument thuhet që më 30 maj z. Thaçi ka qenë në Londër, në
5 dokumentin 1D00207 thuhet që z. Thaçi ka qenë Bon, vazhdon më
6 tej në dokumentin 1D00208 thuhet që më 3 qershor z. Thaçi ka
7 qenë në Këln.

8 Pra, gjatë gjithë zhvillimit të Operacionit Shigjeta, z.
9 Thaçi ka qenë në Evropën Perëndimore. Ju s'keni nga ta dini
10 nëse z. Sylja i ka raportuar z. Thaçi, ndërkohë që vetë z.
11 Thaçi ka qenë në Evropën Perëndimore, ju s'keni nga ta dini
12 këtë, apo jo?

13 PË. Po, e saktë.

14 PY. Në rregull. Tani dua t'ju bëj disa pyetje që burojnë nga
15 pyetjet e Gjykatësit Barthe, po dhe Gjykatësi Mettraux deri në
16 një farë pika. Në fakt, të dy, të dy ua bënë këto pyetje për
17 dëshminë që keni dhënë ju personalisht kur thatë që nuk mund
18 t'i ushtronit detyrat e komandantit të përgjithshëm të UÇK-së
19 sepse po prisnit që të kthehej delegacioni. Ja një çast ta
20 vendosin dhe në ekran.

21 Ju keni thënë në Shënimin Përgatitor numër 1, paragrafi
22 6, që "nuk mund t'i ushtronit funksionet si komandant i
23 përgjithshëm derisa të kthehej delegacioni i Rambujesë sepse
24 duhet të komunikoni me ta paraprakisht, përpara se të merrnit
25 detyrën".

1 Tani ta eksplorojmë pak radhën e ngjarjeve.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Fillojmë duke vendosur në ekran
3 materialin DHT05003 deri në DHT05009 në faqen DHT05007.

4 Fatkeqësisht e kemi vetëm në anglisht këtë, por po jua lexoj
5 unë. Ju lutem vetëm ta zmadhojmë, shkojmë dhe më poshtë.

6 PY. Është *Radio Free Europe* e publikuar më 23 shkurt,
7 për afërsisht dhjetë ditë pas takimit që diskutuam ne ku u
8 zgjodhe ti si komandant i ri i përgjithshëm. Dhe thuhet
9 kështu:

10 "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka caktuar Sylejman
11 Selimin një komandant rajonal 29-vjeçar dhe luftëtar si
12 komandantin e vet, shërbimet sllavike jugore raportuan më 22
13 shkurt, raportuan më 22 shkurt. Burime të pakonfirmuara të
14 UÇK-së e konfirmuan emërimin të cilin e përditshmja Kosova Sot
15 e kishte shpallur më herët gjatë asaj dite, por të tjerë e
16 mohuan, përfshirë këtu *Reuters*. Një gjykatë serbe më herët e
17 kishte dënuar Selimin në mungesë me 20 vjet burg për
18 terrorizëm."

19 Ky artikull thekson që ju jeni deklaruar, jeni shpallur
20 publikisht tek Kosova Sot më 22 shkurt si komandant i
21 përgjithshëm dhe, nëse ju kujtohet kur ju bëra unë pyetjet më
22 herët, unë ju tregova një artikull ku konfirmohej dhe kishte
23 thënë Albin Kurti po në atë mbrëmje, më 22 shkurt, ju keni
24 pasur një takim me Adem Demaçin.

25 Pra, a e pranoni ju që më së paku nga 22 shkurti ju keni

1 qenë komandanti i ri i përgjithësim i UÇK-së?

2 PË. Nuk e di tash datën saktë, por --

3 PY. Po mirë keni ndonjë arsye ta kundërshtoni këtë artikull
4 kur thuhet që më 22 shkurt jeni shpallur tek Kosova Sot si
5 komandanti i ri i përgjithshëm i UÇK-së, keni ndonjë arsye ta
6 kontestoni këtë gjë?

7 PË. Jo, nuk kam ndonjë arsye.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, kërkoj
9 pranimin e këtij dokumenti si provë gjyqësore.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime?

11 Z. HALLING: [Përkthim] Jo.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm këtë
13 faqe?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
16 DHT05007 pranohet.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e
18 provës 1D250 dhe e theksoj se është dokument publik.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, publik duhet të jetë si
20 dokument.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
22 Riklasifikoheni, ju lutem.

23 Z. MISETIC: [Përkthim]

24 PË. Tani, Dëshmitar, unë dua të flasim bashkë për momentin
25 kur u kthye delegacioni në Kosovë.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Pikësëpari vendosim në ekran
2 materialin 1D69. Mbase është në listën tonë fillestare të
3 materialeve.
4 PY. Z. Selimi, po ua tregoj këtë dokument, është marrëveshja
5 mes Hashim Thaçit, Ibrahim Rugovës dhe Rexhep Qosjes i
6 nënshkruar në Rambuje për të formuar Qeverinë e Përkohshme të
7 Kosovës. Po ua tregoj këtë vetëm që të shihni datën, jam i
8 interesuar tek data, është data 23 shkurt 1999.

9 Një ditë pasi jeni shpallur publikisht ju si komandanti i
10 ri i përgjithshëm i UÇK-së, delegacioni i Kosovë ishte ende në
11 Rambuje, më së paku ka nënshkruar një marrëveshje atje. E
12 pranoni këtë?

13 PË. Po.

14 PY. Tani do të tregoj një libër të shkruajtur nga Nuhi Bytyqi
15 dhe aty janë disa nga data kur janë kthyer disa prej anëtarëve
16 të delegacionit në Kosovë.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem vendosim në ekran provën
18 materiale P1264 në faqen SPOE00128796, ju lutem. Edhe shqipja
19 ka të njëjtin numër.

20 PY. Ky është libri i z. Bytyqi.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë më poshtë në fund të faqes
22 në të dy versionet. Në fakt, duhet të ishte faqja 796 tek
23 anglishtja, domethënë, është faqja me numër 426 sipas librit.

24 Po. Shkojmë më poshtë ju lutem.

25 PY. Këtë ka thënë z. Bytyqi:

1 "Kur delegacioni i Kosovës, një pjesë nga radhët e UÇK-së
2 më 25 shkurt 1999 u kthyen nga Rambujeja në Shalë të Lipjanit,
3 u organizua pritje" - shkojmë në faqen tjetër - "madhështore
4 nga populli, veçmas nga eprorët dhe ushtarët e UÇK-së. Nga
5 delegacioni i UÇK-së arritën Azem Syla, komandanti i
6 përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Jakup Krasniqi,
7 zëvendëskomandant dhe Ramë Buja, anëtar i Shtabit të
8 Përgjithshëm të UÇK-së. Udhëheqësit e delegacionit të Kosovës
9 në Rambuje, Hashim Thaçi dhe Xhavit Haliti kishin shkuar në
10 Tiranë."

11 E pranoni ju përshkrimin e z. Bytyqi kur thotë që Jakup
12 Krasniqi, Azem Syla dhe Ramë Buja janë kthyer në Kosovë vetëm
13 dy ditë pasi jeni shpallur ju publikisht si komandant i
14 përgjithshëm i UÇK-së?

15 PË. Nuk kam njohuri për kur janë kthy, por po shoh shkrimin e
16 z. Bytyqi.

17 PY. Keni ndonjë arsye ta kundërshtoni përshkrimin e z. Bytyqi
18 kur thotë ai që z. Thaçi dhe z. Haliti, në fakt, nuk shkuan në
19 Kosovë por shkuan në Tiranë?

20 PË. Nuk kam ndonjë arsye që e kundërshton.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
22 përfshitë z. Krasniqi ju këtu dhe ata që nuk u kthyen. Shikoje
23 një herë transkriptin, ju lutem, rreshti 15.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, thashë nuk u kthyen deri më 25
2 shkurt.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet parë
4 mbase se në libër thuhet që ka bërë një deklaratë për median.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Më 25, kështu e kuptoj unë. Pra,
6 janë kthyer, janë kthyer më 25.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj
8 ndjesë, e lexova unë gabim.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull.

10 PY. Z. Selimi, atëherë të përcaktojmë bashkë kur është kthyer
11 vërtetë z. Thaçi në Kosovë. Dhe kjo lidhet pastaj dhe me
12 emërimin tuaj dhe nëse pritët ju që të rikthehej delegacioni
13 dhe kjo lidhet me pyetjet që bëri Gjykatësi Mettraux kur ju
14 pyeti nëse jeni takuar me z. Thaçi ndërkohë që ishit komandant
15 i përgjithshëm. Do t'ua tregoj dokumentin.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të vendosë në
17 ekran materialin DHT05010 deri në DHT05019 në faqen DHT05018,
18 faqja 9 e PDF. Shqipja është e njëjta.

19 PY. Kjo është botuar më 9 mars 1999. Do ua lexoj.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Në fakt e kemi dhe në shqip këtë.
21 Jo? DHT1518 shqipja. Ju kërkoj ndjesë. DHT05018 deri në
22 DHT05019-AT, ju lutem.

23 PY. Po ju lexoj. Pra, gjithmonë mbani parasysh datën 9 mars
24 1999:

25 "Reuters raportoje sot se 'në një deklaratë të agjencisë

1 së saj *Kosova Press*, shtabi i UÇK-së ... kushtëzoi nënshkrimin
2 e saj, marrëveshjes së Rambujesë me ndalimin e të gjitha
3 aktiviteteve ushtarake serbe në Kosovë'. 'Bisedimet do të
4 vazhdojnë' thuhet në deklaratën e UÇK-së. Zëdhënësi i UÇK-së
5 Jakup Krasniqi i tha ... të përditshmes së pavarur Koha Ditore
6 se nënshkrimi do të bëhet pasi të gjithë udhëheqësit e
7 rebelëve të kthehen në Kosovë. Këtu përfshihet Hashim Thaçi, i
8 cili ka disa ditë që ndodhet në Shqipëri'. *Reuters* raportoi
9 dhe se 'Thaçi shkoi në Shqipëri pas negociatave por (një
10 diplomat perëndimor i pidentifikuar) tha se ai mund të jetë
11 kthyer fshehurazi në Kosovë'. 'Unë e kuptoj se ai është kthyer
12 në Kosovë tani dhe duhet të jetë në gjendje të kontaktojë me
13 udhëheqësit e tjetër të UÇK-së', thotë diplomati."

14 "The Independent (Londër) raportoi sot se në një ceremoni
15 të shtunën që shënonte përvjetorin e parë të vrasjes së
16 themeluesit të UÇK-së, Adem Jashari, nga forcat serbe të
17 sigurisë, shefi i shtabit të UÇK-së, Sylejman Selimi,
18 'paralajmëroi ... se rebelët nuk do të pranonin një kompromis.
19 'Masat gjysmake drejt pavarësisë janë të papranueshme nëse nuk
20 çojnë në një pavarësi të plotë', tha ai."

21 Shkojmë më poshtë dhe më poshtë pak, fjali që fillon me:

22 "Hashim Thaçi, në Tiranë të dielën ...", "Hashim Thaçi të
23 dielën në Tiranë...". Është në paragrafin mbi paragrafin "The
24 *Washington Post* ...". Në mes të paragrafit. Thuhet këtu:

25 "Hashim Thaçi të dielën në Tiranë", që është më 7 mars,

1 "u citua nga *Reuters* më 7 mars duke thënë se 'procesi vazhdon
2 dhe ka marrë një drejtim shumë pozitiv drejt nënshkrimit të
3 një marrëveshjeje.'"

4 Pra, z. Thaçi ka shkuar në Tiranë nga Rambujeja dhe deri
5 më 7 mars ka qenë ende në Tiranë. Diplomati thotë mes 7 marsit
6 dhe 9 marsit, pra, diplomati thotë që mund të jetë kthyer
7 fshehurazi z. Thaçi në Kosovë.

8 Shkojmë në fund të raportit çfarë ka thënë "*The*
9 *Washington Post* ...":

10 "*The Washington Post* raportoi të dielën se ish-udhëheqësi
11 i shumicës në senatin amerikan Robert Dole - i nisur si i
12 dërguar nga administrata e Klintonit për të nxitur shqiptarët
13 e Kosovës të nënshkruajnë marrëveshjen, por të cilit ju
14 refuzua viza për të hyrë në Jugosllavi - 'tha [të shtunën] në
15 një konferencë shtypi në ambasadën e SHBA-së [në Shkup,
16 Maqedoni] se liderit shqiptar raportuan 'se do të shkruanin
17 nesër'.

18 "Dole tha se ka folur me Jakup Krasniqi në telefon, me
19 zëdhënësin e UÇK-së në telefon, por *New York Time* raportoi të
20 dielën se Thaçi 'kapërceu takimin e shqiptarëve me Dole ... të
21 premtën', "' ... Ndoshta më e turpshme, z. Thaçi nuk mund të
22 gjendej edhe pas asaj që një zyrtar i administratës e quajti
23 si një grup skautingu që u dërgua për ta kërkuar në Tiranë,
24 Shqipëri'."

25 Pra, sipas këtij artikulli, z. Thaçi ka shkuar nga

1 Rambujeja në Shqipëri dhe nuk ka qenë në Kosovë për të paktën
2 deri më datë 7 mars, sepse deri në atë datë dihej që ka qenë
3 në Tiranë, nuk është e mundur që ai të jetë kthyer në Kosovë
4 përpara 8 marsit të 1999. Ju keni qenë komandant i
5 përgjithshëm i UÇK-së për të paktën dy javë përpara sesa z.
6 Thaçi të kthehej në Kosovë. Juve nuk ishte e nevojshme që të
7 takoheshit me të ndërkohë që keni qenë komandant i
8 përgjithshëm i UÇK-së. A pajtoheni ju me këtë, Dëshmitar?
9 PË. Po.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, kam edhe një
11 pyetje të fundit sa i takon këtij dokumenti.

12 PY. A është i saktë dokument që më datën 8 mars të vitit
13 1999, në ceremoninë përkujtimore të Adem Jasharit, juve ende
14 publikisht kundërshtonit marrëveshjen e Rambujesë, a ka qenë
15 ky pozicioni juaj në atë datë, Dëshmitar?

16 PË. Ka mundësi, po.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, kërkoj që
18 dokument të pranohet në prova gjyqësore.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
20 kundërshtime?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
23 DHT05018, faqja 9 e këtij dokumenti pranohet në prova
24 gjyqësore.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund t'ju kërkoj një

1 sqarim sepse shohim gjithashtu edhe dokumentin 05019 në ekran.

2 Mund të na thoni çfarë duhet bëhet me këtë dokument?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Janë dy faqe.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Faleminderit.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti DHT05018 deri

7 në DHT05019 dhe teksti përkues në shqip do pranohet si prova

8 gjyqësore do të marri numrin 1D251 dhe klasifikimi është

9 publik.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të mbetet

11 publik.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Ju faleminderit, të nderuar

13 Gjykatës.

14 PY. Përsëri lidhur me këtë një pyetje konkrete e bërë nga

15 Gjykatësi Mettraux lidhur me takimet që mund të keni pasur me

16 z. Thaçi dhe ndonjë takim që mund të keni pasur me Fatmir

17 Limajn.

18 Atëherë, së pari, dëshiroj që të shohim një material

19 filmik bashkë. Për këtë do i kërkoja Sekretares të paraqesë

20 videon duke filluar nga minuta -- nga sekonda e 7 - nga minuta

21 7 - më falni - e në vazhdim.

22 PY. Dua t'ju rifreskoj memorien lidhur me këtë temë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Prova e ka numrin P01294.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Duke filluar nga 00:07:03. Ndaloni
2 këtu, ju lutem.

3 PY. Z. Selimi, a e njihni personin tuaj, a e njihni veten,
4 domethënë, si personi që është ulur në të djathtë të kësaj
5 fotografie që keni në ekran?

6 PË. Po.

7 PY. Po personi që është ulur menjëherë në të djathtë tuaj,
8 kush është?

9 PË. Z. Thaçi.

10 PY. Po personi që është i ulur ngjitur me të, pra, menjëherë
11 në të djathtë e tij?

12 PË. Z. Limaj.

13 PY. A e njihni vendin ku është marrë kjo pamje?

14 PË. Jo, s'e di saktësisht, po di pak para se me udhëtu për
15 Rambuje, për Paris po më duket.

16 PY. Po. Në qoftë se do ju thoja unë, do ju supozoja që është
17 Lladrovç, ju kujton gjë kjo?

18 PË. Po, besoj që se Lladrovç. Po s'mu kujtojke emri.

19 PY. Në rregull.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit ta
21 transmetojë videon.

22 [Luhet videoincizimi]

23 "Fike duhanin, ej."

24 "[E pakuptueshme]."

25 "Dheze duhanin. Zoti, jo."

1 "Hiqma at duhan. Se do të [E pakuptueshme]".

2 "Unë kët pa cigare s'po rri [Folës që flasim
3 njëkohësisht] "Me ato cigare s'mundem [E pakuptueshme].

4 Z. MISETIC: [Përkthim]

5 PY. Ju kujtohet tani?

6 PË. Po.

7 PY. Domethënë, kam përshtypjen që e thatë më përpara thatë që
8 ishte pak para se të niseshin për Rambuje, kështu?

9 Data është 13 mars 1999. A e pranoni këtë?

10 PË. Po.

11 PY. Z. Thaçi, atëherë, së pari ju e patë që ishin të
12 pranishëm media.

13 PË. Po.

14 PY. A mund të na e shpjegoni a ju kujtohet se pse ishte media
15 e pranishme aty, mund të na thoni arsyen pse ishte media e
16 pranishme aty, nëse ju kujtohet?

17 PË. Ishte para shkuarjes së delegacionit po më duket.

18 PY. A ju kujtohet që z. Thaçi kishte ardhur për të marrë
19 pëlqimin tuaj, sepse komandanti i përgjithshëm ishit ju,
20 domethënë, kishte ardhur për të marrë pëlqimin tuaj për
21 Marrëveshjen e Rambujesë dhe këtë marrëveshje vetëm disa ditë
22 më përpara në fakt gjatë ceremonisë përkujtimore të Adem
23 Jasharit ju ishit shprehur publikisht që ishit kundër saj? Ju
24 kujtohet kjo, Dëshmitar?

25 PË. Ky ka qenë një takim formal që jemi taku bashkë. Dhe që

1 jemi taku në Lladrovç para se me u nis për Rambuje, po.

2 PY. Po. Por ai gjithashtu ka folur me ju, ka folur dhe me

3 Fatmir Limajn duke ju kërkuar juve që të jepnit pëlqimin për

4 nënshkrimin e Marrëveshjes së Rambujesë. A është përshkrim i

5 saktë ky?

6 PË. Okej. Po e saktë.

7 PY. Është e drejtë të thuhet, apo jo, që pëlqimin ua kërkonte

8 z. Thaçi ju, jo ju z. Thaçi, pra, z. Thaçi juve duke qenë që

9 ishit në postin e komandantit të përgjithshëm po kërkonte

10 pëlqimin tuaj --

11 PË. Po, e saktë.

12 PY. -- a është e saktë kjo?

13 Kam edhe disa pyetje të tjera për ju, z. Selimi.

14 Gjykatësi Barthe ju pyeti lidhur me një telefon satelitor kur

15 po pyeteshit lidhur me thirrjet telefonike që i bëtë Ahmet

16 Krasniqit, ku ka qenë i pranishëm edhe z. Shaqiri. A ju

17 kujtohet kjo pyetje?

18 PË. Po.

19 PY. Kush ua dha ju telefonin satelitor?

20 PË. Nuk e di.

21 PY. Kur keni pas një telefon satelitor?

22 PË. Mbas jam zgjedh komandant zone.

23 PY. E dini --

24 PË. Jo, s'e di.

25 PY. -- kur tamam pas?

1 PË. Jo, nuk e di.

2 PY. Në rregull. Gjykatësi Barthe ju bëri pyetje gjithashtu
3 edhe në dëshminë e dhënë në përgjigje të pyetjeve të mia për
4 bisedat për arrestimin e anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm.
5 Të martën kur ju bëra këtë pyetje, pra, kur ju pyeta në qoftë
6 se ju besonit që kishit kompetencë që të arrestonit anëtarë të
7 Shtabit të Përgjithshëm ju u përgjigjët si më poshtë, për
8 referencë kjo jepet në transkript në faqen 259909 në rreshtat
9 10 deri në 17. Citoj këtu:

10 "PY. Është e saktë, apo jo, që ky rast përshkruan që
11 komandanti i zonës së Drenicës besonte se kishte të drejtën
12 ose kompetencën që të arrestonte këta persona në qoftë se
13 vendoste që të bënte arrestimin e tyre. A është kështu?"

14 Përgjigja që ju jepni është kjo:

15 "Jo vetëm kundër këtyre tre personave në veçanti po
16 kundër çdo personi tjetër, komandant i zonës kishte
17 përgjegjësi të plotë dhe autoritet të plotë që të merrte
18 veprime dhe komandanti i zonës ka mbajtur përgjegjësi për këtë
19 me komandantët e brigadës në atë kohë."

20 Unë vazhdoj me një pyetje tjetër, që në transkript
21 pasqyrohet në faqen 25091, rreshtat 7 deri në 10, për t'u
22 siguruar në qoftë se qëndrimi juaj ishte i qartë.

23 "PY. Fakti që ka pasur një bisedë lidhur me arrestimet e
24 tre anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm sugjerojnë që ju
25 besonit që komandanti i zonës së Drenicës kishte autoritet,

1 pra, kishte kompetencë që të arrestonte këta anëtarë të Shtabi
2 i Përgjithshëm. Kjo është e drejtë, apo jo?

3 Përgjigja që ju jepni është që:

4 "Po, unë e kisha kompetencën ose autoritetin për zonën
5 operative të Drenicës."

6 A ju kujtohet ta keni thënë këtë më herët këtë javë?

7 PË. Po.

8 PY. Fakti që komanda e zonës së Drenicës ka pasur një takim
9 për të diskutuar arrestimin e këtyre tre anëtareve të Shtabit
10 të Përgjithshëm, demonstroi faktin që ju besoni që zona
11 operative, pra, komanda e zonës operative të zonës ka
12 autoritetin që të arrestonte këta persona në Zonën Operative
13 të Drenicës?

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Misetic, do jetë mirë që
15 të jepnit përgjigjet që ka dhënë dëshmitari dhe në përgjigje
16 të pyetjes time për ta bërë më të qartë situatën.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Do arrij dhe aty por po kaloj hap
18 pas hapi. Ju lutem më lejoni që të vazhdojë në mënyrë
19 kronologjike.

20 PY. A është e saktë kjo, Dëshmitar, kjo që sapo ju lexova? Ju
21 besoni që brenda Zonës Operative të Drenicës sikurse më thatë
22 të martën, që komanda e zonës operative të Drenicës kishte
23 autoritetin që të arrestonte tre anëtarët e Shtabit të
24 Përgjithshëm, a është e saktë kjo?

25 PË. E para, asnjëherë s'është mbajtur takim për arrestimin e

1 anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm. E dyta, sa i përket
2 zonës, zona i ka pas kompetencat e veta me Zonën Operative të
3 Drenicës. Kurse sa i përket arrestimit të anëtarëve të Shtabit
4 të Përgjithshëm nuk e ka pas këtë kompetencë ose ndalimin e
5 tyre. Asnjëherë nuk është mbajtur një takim që këta me u
6 arrestu.

7 PY. Ju kërkoj ndjesë. Po këtë e shtjelluam të martën. Madje
8 unë edhe identifikova se kush ishin anëtarët e komandës që
9 kanë qenë të pranishëm në atë takim --

10 PË. Po, e saktë.

11 PY. -- dhe ju konfirmuat që shumë prej personave, pra, ka
12 pasur një takim ku është diskutuar kjo çështje?

13 PË. Po, e saktë. Por jo për arrestimin e tyre.

14 PY. Po për çfarë është diskutuar atëherë? Çfarë do bënit me
15 ta në qoftë se s'do i arrestonit?

16 PË. Për shumë sqarime tjera, për konsulta dhe për sqarime
17 tjera, por jo për arrestimin.

18 PY. Dëshmitar, transkripti është ai që është nga pyetjet e
19 mia të martën. Megjithatë tani do të kalojmë tek pyetjet e
20 Gjykatësit Barthe. Ai ju pyeti në qoftë se ka pasur rregullore
21 që lejonin arrestimin e anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm?
22 A ju kujtohet që Gjykatësi Barthe t'ju ketë bërë këtë pyetje?

23 PË. Po.

24 PY. Ju thatë që nuk ka pasur rregullore që e lejonin këtë
25 gjë, a është kështu?

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që ju
2 ndërpres por përgjigja që u dha nga dëshmitari është që.
3 "Jo, nuk kam pas kompetencë ose udhëzim ose rregullore të
4 tilla të disponueshme."

5 Kjo është përgjigja e tij.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. por pyetja ishte --

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ai po fliste për kompetenca.
8 Ndërkohë që unë e pyeta në qoftë se mund të kishte rregullore,
9 rregulla për arrestimin.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua ta lexoj të plotë se ju
11 përdorët fjalën "rregullore".

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po unë e përdora këtë fjalë
13 "rregullore ose rregulla", por dëshmitari e tha dhe një herë
14 dhe unë dua t'jua citoj që:

15 "Unë nuk kam pas kompetenca, udhëzime ose rregulla të
16 disponueshme."

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull.

18 PY. Dëshmitar, ju nuk keni pas kompetenca, udhëzime apo
19 rregullore që ju kanë bërë ju të mundur ose që ju lejonin që
20 të arrestonit civilë, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

21 PË. Po, e saktë.

22 PY. Kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht që civilët nuk janë
23 arrestuar, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Faleminderit.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kam pyetje tjera.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

3 Dixon.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

5 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Dixon:

6 Z. DIXON: [Përkthim]

7 PY. Z. Selimi, kam disa pyetje tjera për ju. Atëherë ta

8 fillojmë nga përgjigja e fundit që ju sapo dhatë, sepse kjo

9 është një çështje e ngritur nga Gjykatësi Barthe, a mund të

10 konfirmoj që ju nuk keni pasur asnjë rregullore nga Shtabi i

11 Përgjithshëm apo nga ndonjë burim tjetër lidhur me mënyrën

12 sesi të ndaloheshin personat, kush ishte përgjegjës, çfarë

13 roli kishte policia ushtarake apo i palëve të tjera në këtë

14 proces, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

15 PË. Po.

16 PY. Pra, ju nuk keni pas asgjë me shkrim apo me gojë nga

17 Shtabi i Përgjithshëm lidhur me këtë temë, a është e saktë

18 kjo?

19 PË. E saktë.

20 PY. Të kalojmë tani tek një temë tjetër që u ngrit nga

21 Gjykatësi Barthe në pyetjet e tij, për procesverbal kjo

22 pasqyrohet në faqen 83 të transkriptit të përkohshëm.

23 Gjykatësi Barthe ju bën këtë pyetje, pra, ju pyet në qoftë se

24 ju kishit folur, apo jo, me z. Veseli lidhur me ngjarjet, e

25 kam fjalën këtu për ngjarjet ose me rastin e Personit 1. Për

1 disa pyetje tjera do të kalojmë në seancë private pak më vonë
2 ku mbase mund të jetë e nevojshme që të jepen hollësi të
3 tjera, megjithatë për momentin bisedën do ta mbaj të
4 përgjithshme. Pyetja është kjo: Ju nuk keni pasur biseda, nuk
5 keni diskutuar ndonjë gjë me z. Veseli sa i takon pretendimeve
6 të ngritura nga Personi 1 dhe nuk ju kujtohet që të keni pasur
7 ndonjë bisedë me askënd tjetër lidhur me këtë temë, pra, kjo
8 është ajo çfarë keni thënë në përgjigje të pyetjes së bërë nga
9 Gjykatësi Barthe. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

10 PË. Po.

11 PY. Gjithashtu, juve ju tregua një paragraf, përkatësisht
12 paragrafi 76 i shënimeve përgatitore. Në këtë paragraf të
13 Shënimit Përgatitor numër 2, ju thoni që jeni përpjekur që të
14 kontaktoni me z. Geci në mënyrë të tillë që t'i tregonit atyre
15 që nuk mund të qëndronin më në zonën e Drenicës. A ju kujtohet
16 t'ju jetë bërë një pyetje lidhur me këtë, Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 PY. A është e drejtë të thuhet se kur keni folur me z. Geci,
19 me z. Haxha dhe/ose persona të tjerë që ju thatë që folët, ju
20 i keni thënë atyre që ata duhet të largoheshin prej zonës
21 tuaj?

22 PË. Po.

23 PY. Dhe, në fakt, ata u larguan. Z. Geci iku për në Shqipëri.
24 Sikurse e kemi parë edhe përmes provave. Pra, ai u largua, iku
25 nga ajo zonë dhe iku në drejtim të Shqipërisë, apo jo?

1 PË. Jo, jo, nuk është fjala që iku. Z. Geci ka qëndru edhe
2 një kohë për arsye se ka qenë shumë i plagosun, kurse z. Haxha
3 është kthyer për -- është shku për në zonën e vet. Kurse z. Geci
4 është trajtu me mjekë, është trajtu me ekipin afër vetes kur
5 ka pas nevojë me lëviz për arsye se ka qenë zona e luftimeve
6 dhe pastaj ka shku për në Shqipëri.

7 PY. Po e diskutuam dhe dje këtë temë. Kështu që nuk dua ta
8 përsërisë përsëri. Megjithatë eventualisht ai përfundoi në
9 Shqipëri sikurse na e thatë edhe tani, domethënë, iku për në
10 Shqipëri. Kështu?

11 PË. Po, e saktë.

12 PY. Është e saktë të thuhet që, sipas mendimit tuaj, ju keni
13 besuar që e keni zgjidhur, e keni trajtuar problemin?
14 Domethënë, z. Haxha u largua, Z. Geci po ashtu shkoi në
15 Shqipëri, këta ishin persona që nuk ishin më në zonën tuaj.
16 Kështu që a do ishte përshkrim i drejtë të thuhet që, sipas
17 jush, ju e trajtuat, e zgjidhët problemin?

18 PË. Po.

19 PY. Pra, nuk është se kishte më nevojë që ta ngrinit këtë
20 shqetësim me ndonjë person tjetër se ju e zgjidhët vetë
21 problemin, kështu?

22 PË. Po, saktë.

23 PY. Ne e dimë që kjo çështje pastaj u rishfaqë në vitin 2002,
24 2003 kur UNMIK-u filloi hetimet e veta. Kjo është hera tjetër
25 kur doli apo u shfaq, doli në skenë përsëri kjo temë, ky rast.

1 A është e saktë kjo?

2 PË. Po.

3 PY. UNMIK-u kreu një hetim të plotë lidhur me këtë temë me
4 ç'dini ju. Lidhur me këtë rast ju kanë intervistuar juve. Kanë
5 intervistuar gjithashtu edhe z. Geci, sikurse e kemi parë edhe
6 në dëshminë tuaj? A është e saktë kjo, Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 PY. Tani do të kalojmë tek një temë që u trajtua nga Gjykatësi
9 Mettraux - flitet për faqen 16 - domethënë, çfarë keni bërë ju
10 gjatë gjashtë javëve ku keni shërbyer si komandant i
11 përgjithshëm i Shtabit të Përgjithshëm.

12 A ju kujtohen këto pyetje, domethënë, a ju kujtohen
13 pyetje lidhur me personat me të cilët keni kontaktuar, çfarë
14 urdhrash keni lëshuar edhe gjëra të tjera që keni bërë gjatë
15 kohës kur keni qenë komandant gjatë këtyre gjashtë javëve?

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
17 përfunduar me përkthimin. Po dëgjon përkthimin akoma.

18 E kuptuat pyetjen, Dëshmitar? Mund t'i përgjigjeni në
19 qoftë se po.

20 DËSHMITARI: Ka ndërhyrje. Në qoftë se ka mundësi edhe një
21 herë me e bë pyetjen?

22 Z. DIXON: [Përkthim]

23 PY. Patjetër. Kërkoj ndjesë që ju ndërpreva, ishte faji im.

24 Atëherë po ju pyesja në qoftë se ju kujtohet që Gjykatësi
25 Mettraux ju bëri një pyetje pak më herët lidhur me punët apo

1 detyrat tuaja gjatë pesë-gjashtë javëve kur keni qenë
2 komandant i përgjithshëm i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?

3 PË. Po, e saktë. Po.

4 PY. Gjatë kësaj periudhe, ne dimë që gjatë kësaj periudhe po
5 zhvilloheshin negociatat në Rambuje, ishte e saktë, apo jo,
6 Dëshmitar, që luftimet vazhdonin gjatë asaj periudhe, është e
7 saktë kjo?

8 PË. Po.

9 PY. Forcat e Armatës Jugosllave ende kishin bazë në Kosovë
10 dhe po zhvendosnin forcat e tyre përfshirë këtu dhe në
11 Drenicë, zonë të cilën e mbulonit ju, është e saktë kjo?

12 PË. Po, e saktë.

13 PY. A është e saktë të thuhet se gjatë kësaj periudhe, forcat
14 serbe kanë kryer ofensiva në Drenicë ku kanë sulmuar dhe kanë
15 djegur fshatra të tërë, përfshirë këtu edhe vetë Prekazin?

16 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtoj, shkon përtej fushës
17 së veprimit të pyetjeve të Gjykatësit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

19 Z. DIXON: [Përkthim] Unë po përpiqem që të përcaktoj se
20 çfarë po bënte ai në atë kohë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po bëje
22 ndryshe pyetjen atëherë, pyete se çfarë po bënte.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Po mundohesha që të vendosja
24 themelësinë.

25 PY. Atëherë pyetja ime ishte kjo, do vazhdoj më tej. Pra,

1 pyetja ime ishte: Në qoftë se gjatë asaj periudhe ju jeni
2 marrë me ofensivat serbe që po zhvilloheshin në Kosovë, në
3 veçanti në zonën e Drenicës, e kam fjalën pikërisht për këtë
4 periudhë kohe?

5 PË. Po, e saktë. Kam qenë vetë pjesëmarrës në luftime.

6 PY. A mund të na ndihmoni dhe të na thoni se ku keni marrë
7 pjesë në luftime në këtë periudhë, domethënë, gjatë këtyre
8 gjashtë javëve për të cilat po bisedojmë, mund të na thoni
9 konkretisht në çfarë luftimesh keni marrë pjesë?

10 PË. Kanë qenë kryesisht luftime rreth fshatit Likovc, kanë hi
11 në Likovc, kryesisht në Abri, kanë hy dhe forcat serbe me një
12 arsenal të madh nga drejtimi i Baicës dhe unë më kujtohet që
13 kam qenë në këto pozicionet edhe në Tërdevc. Dhe më kujtohet
14 saktë që edhe në Tërdevc, me ato ku, me një grup ku jemi kanë
15 bashkë dhe me disa ushtarë të tjerë jemi -- në oborr na ka hi
16 edhe tenka dhe kemi pas luftime të ashpra.

17 PY. Pra, ju keni qenë gjithashtu edhe një person që
18 komandonte ushtarët por edhe merrnit pjesë vetë, personalisht,
19 në luftime, kështu ka qenë, apo jo, Dëshmitar?

20 PË. Po. Çdo herë sa unë kam pas mundësi edhe sa herë ka pas
21 luftime dhe unë kam marrë pjesë në luftime.

22 PY. A do ishte e saktë të thuhet që gjatë kësaj periudhe,
23 domethënë, gjatë katër deri gjashtë javësh, kur ju keni qenë
24 komandant i përgjithshëm, pjesa dërrmuese e kohës tuaj është
25 shpenzuar në luftime, domethënë, duke u përgatitur për luftime

1 dhe duke marrë pjesë vetë në këto beteja, a do ishte e saktë
2 kjo të thuhej?

3 PË. Po.

4 PY. Ju nuk keni pasur kohë të merreni me strukturimin e
5 Shtabit të Përgjithshëm apo të merrnit informacion lidhur me
6 atë se çfarë bënte secili prej personave që ishte pjesë e
7 Shtabit të Përgjithshëm? A do ishte përshkrim i saktë ky?

8 PË. E saktë.

9 PY. Betejat, luftimet kanë vazhduar deri në momentin e
10 fillimit të bombardimeve të NATO-s që ka qenë drejt fundit të
11 marsit, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

12 PË. Po. Korrekt.

13 PY. Në fakt, kjo është arsyeja që pse ndërhyri NATO-ja?

14 PË. Po, saktë.

15 PY. Atëherë kjo është arsyeja që pse filluan bombardimet e
16 NATO-s, që të përpiqesh që të përfundonte konfliktin që po
17 ndodhte në terren, a është e saktë kjo?

18 PË. Po, e saktë.

19 PY. Në një përgjigje të Gjykatësi Gaynor, ju thatë, kjo
20 fjala:

21 "Në kohë lufte", thatë ju, "përdornim fjalë të mëdha
22 'Shtabi i Përgjithshëm.'"

23 Kjo është në faqen 39, rreshti 11. Ju kujtohet që thatë
24 përdornim fjalë të mëdha si Shtabi i Përgjithshëm, ju kujtohet
25 kjo?

1 PË. Po, e saktë.

2 PY. Çfarë deshët të thonit ju kur thatë që përdornim "fjalë
3 të mëdha" si Shtabi i Përgjithshëm, çfarë deshët të thonit me
4 këtë?

5 PË. Në qoftë se më lejohet pak më gjenësisht, unë ia
6 shpjegova dhe Gjyqtarit, por edhe juve.

7 Termi si "Shtabi i Përgjithshëm" është shumë term i madh.
8 Dhe një term në shikim të parë mendohet që është një shtab ku
9 shumë njerëz punojnë në atë shtab dhe një objekt që është me
10 plotë salla operative ose me një -- kurse me një shef
11 operative, me një ekip profesional që e menaxhon dhe situatën
12 edhe në terren edhe që i jep detyra, urdhna dhe një shtab ku
13 të paktën që numri duhet të sillet diku përafërsisht prej 60
14 deri në 100 e ma tepër. Në kohë kur ne po flasim.

15 Kurse në kohë lufte ose në këtë periudhë, unë u mundova
16 t'ia sqaroj edhe Gjyqtarit, që ne po flasim për një shtab të
17 thuaja gati thuaj inekzistent. Në një shtab ma shumë politik
18 ose një pjesë dhe logjistik sesa një shtab operacional me
19 anëtarë të cilët janë të përhershëm ose me anëtarë që e kanë
20 një adresë ose me një shtab që e ka një strukturë, një sallë
21 operative dhe disa oficerë që e menaxhojnë situatën në luftë.
22 Ne, fatkeqësisht, këtë s'e kemi pas. Edhe s'e kam pa asnjëherë
23 të organizum në nivel të tillë.

24 Dhe kjo ka bë që shumë komandantët e zonave në terren t'i
25 marrim vendimet vetë, të shiqojnë situatën vetë, t'i

1 përgjigjen vetë terrenit edhe kushteve të cilat i ka pas në
2 atë kohë, në kohë lufte. Fatkeqësisht, ne është dashtë që të
3 kemi mbështetje dhe logjistike por edhe operacionale edhe me
4 oficerë edhe me teknikë edhe me armatim, po ne fatkeqësisht
5 s'i kemi pas, por është...

6 Ne shpeshherë i drejtohem Shtabit të Përgjithshëm, thojmë
7 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm, por asnjëherë s'e ke dit
8 dhe ku ja janë anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm. Për arsye
9 të ndryshme, ose i ke pas jashtë shteti, ose dhe atëherë kur
10 jemi mundu me i taku, shumë zor ka qenë dhe t'i takojshim. Dhe
11 lidhshmëria e Shtabi i Përgjithshëm gjatë luftës dhe zonave
12 kjo ka qenë gjithmonë pengesë dhe është dash që një komandant
13 zone ti merr veprimet vetë dhe të organizojë dhe të udhëzojë
14 ose dhe të marrë pjesë vetë direkt në luftime dhe të
15 interesohet edhe për ushtarët por edhe për pjesën civile e
16 cila ka qenë në atë kohë periudhës së luftës.

17 Dhe tash unë i krahasova, që ma dha mundësinë edhe
18 Gjyqtari, që gjatë luftës ka qenë ma shumë një shtab që është
19 thirr, që është mundu herë pas here që edhe neve të na
20 mbështesë kur kanë ardhur oficerët me përvojë. Por arsyet
21 shpesh herë kanë qenë edhe kritikant edhe ndaj disa anëtarëve
22 që, jua shpjegova, për arsye se jo personale po për arsye të
23 përgatitjes ushtarake të cilët nuk i kanë pas që me mbështetë
24 në këtë aspekt. E para s'i kanë pas mundësitë. E dyta s'i kanë
25 pas edhe përvojat. E gjitha kjo ka lënë të kuptohet që kjo ka

1 qenë vështirësitë mes anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm dhe
2 vështirësitë e komandantëve të zonave të cilët janë përballë
3 në terren me luftimet dhe me pjesën e personelit.
4 PY. Faleminderit. Faleminderit, z. Selimi. Është e qartë
5 tani. A pajtoheni me mua atëherë se Shtabi i Përgjithshëm në
6 fakt ka qenë thjesht sa për sy e faqe, vetëm në emër, ka qenë
7 një emër si Shtabi i Përgjithshëm. Ajo që është e rëndësishme
8 për ju ishte të takoheshit për me personat, të komunikoni, të
9 kryeshin punët, vetëm ka qenë thjesht në emër një Shtabi i
10 Përgjithshëm?

11 Z. HALLING: [Përkthim] Pyetja është shumë e përbërë për
12 dëshmitarin.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
14 zbërthejeni pak pyetjen, z. Dixon. Bëni një pyetje më të
15 thjeshta, më të drejtpërdrejta.

16 Z. DIXON: [Përkthim]

17 PY. A pajtoheni me mua, z. Dëshmitar, që Shtabi i
18 Përgjithshëm thjesht emrin ka pasur Shtabi i Përgjithshëm edhe
19 varej më shumë nga personat dhe nëse kishin kontakte me ta,
20 apo jo?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Prapë e kundërshtoj pyetjen.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] S'është shumë
23 pyetje e qartë në fakt.

24 Po përpiquni.

25 Është shumë e komplikuar, z. Dixon, kjo pyetje.

1 Z. DIXON: [Përkthim]

2 PY. Mirë. Po e filloj kështu. A pajtoheni me mua që Shtabi i
3 Përgjithshëm vetëm emrin ka pasur Shtabi i Përgjithshëm?

4 PË. Shtabi i Përgjithshëm e ka pas emrin, e thashë që ka pas
5 emrin. Dhe në dukje është një -- kur të përmend si Shtabi i
6 Përgjithshëm në dukje është një diçka e madhe por edhe do të
7 kisha deshtë, kam pas dëshirën që ta kem gjatë periudhës së
8 luftës një shtab të tillë. Po fatkeqësisht, mundësitë dhe nuk
9 e kemi pas një shtab të tillë të cilin kam mund të mbështetë
10 zonat operative.

11 Ka qenë një shtab, disa anëtarë që, thashë edhe më herët,
12 që është përbë prej disa anëtarëve ma shumë s'i ke taku se që
13 i ke taku me -- por ka qenë një shtab jo shumë, jo funksional.

14 PY. Po. Dhe pjesa e dytë e pyetjes sime ishte kjo. Kjo, në
15 fakt, varej nëse kishte persona atje në praninë tuaj, nëse
16 mund të takoheshit me ta, nëse mund të komunikoni me ta dhe
17 që të kryenit punët. Kjo ishte, kështu funksiononte në
18 realitet, apo jo?

19 PË. Atëhere lufta ma shumë është bazu në ata që i ke njoft
20 dhe ata që i ke pas afër veti, unë po flas për Zonën Operative
21 të Drenicës. Edhe unë kam pas fatin që shumë prej të gjithë
22 prej komandantëve të brigadave t'i kem, t'i njoh edhe më
23 herët. Dhe t'i kem shokë. Dhe, në këtë aspekt, unë kam pas
24 edhe fatin që të udhëheqi në Zonën Operative të Drenicë dhe në
25 shumë bashkëluftëtarë të Ademit dhe të shumë pjesëtarë të

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 93

1 themelimit ose prej themelimit të UÇK-së që kam pas krah veti.

2 Dhe në Drenicë edhe pse kam pas humbje të mëdha, kam pas

3 shumë edhe jam krenar që kam mund t'i udhëheqë në Zonën

4 Operative të Drenicës me aq sa kam pas mundësi.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ju

6 lutem përgjigjuni vetëm pyetjes së z. Dixon.

7 DËSHMITARI: Okej.

8 Z. DIXON: [Përkthim]

9 PY. Faleminderit, z. Selimi. Do vazhdoj tani tek një pyetje

10 që mund t'i përgjigjeni shkurt në fakt. Ua bërë këtë pyetje

11 Gjykatësi Gaynor në faqen 38 të transkriptit të sotëm. Ju bëri

12 pyetje për dallimin mes ZKZ-së, SHIK-ut dhe G2. Ju kujtohet

13 kjo?

14 PË. Po.

15 PY. Unë dua të sqaroj me ju këtë, mesa ju kujtohet ju, a ka

16 qenë, a është e vërtetë që ZKZ-ja ka qenë shërbimi informativ

17 ushtarak në UÇK dhe se ka ekzistuar në kohën kur keni qenë ju

18 dhe në nivel zone por edhe kur keni qenë komandant i

19 përgjithshëm?

20 PË. Po.

21 PY. Ndërsa SHIK-u, shërbimi informativ civil i Kosovës u

22 formua në prill të 1999?

23 PË. Po, është e saktë.

24 PY. Pra, kanë qenë organe të ndryshme. ZKZ-ja nga pikëpamja

25 ushtarake nuk ka qenë e njëjta gjë me Shik-un --

1 PË. Jo.

2 PY. -- që ishte, u formua në prill të 1999?

3 PË. Po, e saktë.

4 PY. Kur u formua SHIK-u, pra, Shërbimi informativ Civil në
5 prill të 1999, ZKZ-ja vijoi të ekzistonte në UÇK, zbulimi
6 ushtarak, saktë?

7 PË. Po, e saktë.

8 PY. Nuk drejtohej nga z. Veseli ZKZ-ja, por nga një person i
9 ri që ishte emëruar në këtë post, saktë?

10 Z. HALLING: [Përkthim] Pyetjet e Gjykatësit ishin për
11 terminologjinë. Pyetjet e z. Dixon nuk po lidhen me pyetjet e
12 Gjykatësve.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni dalë
14 pak, keni dal nga kuadri i pyetjeve të Gjykatësve.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Unë po përpiqem të diskutoj pak
16 dallimin për përdorimin e këtij termi. Mbase dëshmitari meqë
17 ka qenë në atë kohë mund të na e shpjegojë në atë kohë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po bëjani
19 pyetjen të drejtpërdrejtë dhe të shohim pastaj. Pyetje më të
20 shkurtra, ju lutem, pyetje më të shkurtra e më koncize, ju
21 lutem.

22 Z. DIXON: [Përkthim]

23 PY. Z. Selimi, një pyetje më të shkurtër atëherë: ZKZ-ja
24 ushtarake vazhdoi në UÇK në prill të 1999, saktë?

25 PË. E saktë.

1 PY. Nuk drejtohej nga z. Kadri Veseli?

2 Z. HALLING: [Përkthim] E kundërshtoj, nuk lidhet me
3 pyetjet e Gjykatësve.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet,
5 mund t'i përgjigjeni. Mund t'i përgjigjeni, Dëshmitar.

6 DËSHMITARI: Po, e saktë.

7 Z. DIXON: [Përkthim]

8 PY. Në rregull. Faleminderit.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Tani do të kaloj te një temë tjetër
10 që është dhe tema e fundit, do të përfundojmë shpejt. Për këtë
11 dua të kalojmë në seancë private për të mbrojtur personin që
12 përmendet në këtë dokument.

13 [Seancë private]

14 [Seancë private teksti i fshirë]

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga znj. Alagenda

Faqe 97

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9 [Seancë e hapur]

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

11 Z. Roberts, keni pyetje?

12 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Alagenda?

14 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Shumë pak.

15 Pyetje vijuese të palës tjetër nga znj. V.

16 Alagenda:

17 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

18 PY. Z. Selimi, Gjykatësi Mettraux iu tregoi paragrafin 13 të

19 Shënimit Përgatitor numër 1, ku sipas të cilit ju keni thënë

20 Adem Jashari merrte urdhra prej Shtabit të Përgjithshëm.

21 Dëshmia juaj sot ishte që kjo është gabim.

22 "Adem Jashari nuk ka marrë urdhra prej Shtabit të

23 Përgjithshëm, po ai ka lëshuar urdhra apo është konsultuar me

24 Shtabin e Përgjithshëm të paktën me personat që ai njihte".

25 Ju kujtohet kjo?

1 PË. Po.

2 PY. Gjithashtu ju thatë më tej që Adem Jashari nuk ka qenë në
3 pozicion që t'i jepte dikush urdhra. Ai ka qenë komandanti i
4 parë."

5 Saktë?

6 PË. E saktë.

7 PY. Më pas ju treguan, Gjykatësi Mettraux iu tregoi një
8 incizim të intervistës suaj me TPNJ-në. Po ju lexoj atë që
9 tregon transkripti këtu, faqja 12, rreshtat 2 deri në 8,
10 thuhet kështu, ju është bërë pyetje ju:

11 "Në rregull. Po atëherë Adem Jashari a kishte kontakt apo
12 a kishte përgjegjësi t'i raportonte Shtabit të Përgjithshëm? A
13 keni dijeni për këtë?"

14 Përgjigja juaj në rreshtin 5 ka qenë kjo:

15 "... kishte kontakte të vazhdueshme me Shtabin e
16 Përgjithshëm. Ka qenë në kontakte të shpeshta me ta dhe me
17 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm po ashtu konsultoheshin
18 shpesh me Ademin se ka qenë figura kryesore në ushtri, figura
19 qendrore."

20 Pra, kjo është e vërtetë, z. Selimi, që Shtabi i
21 Përgjithshëm po ashtu e konsultohej me Adem Jasharin si
22 komandantin kryesor, nuk ndodhte anasjelltas, ishte Shtabi i
23 Përgjithshëm që konsultohej me Adem Jasharin, jo Adem Jashari
24 me Shtabin e Përgjithshëm, saktë?

25 PË. Po si mund ta shpjegoj ma thjesht. Adem Jashari ka qenë

1 edhe komandant kryesor edhe ajo është normal që është që ka
2 bisedu edhe me anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm. Me
3 këndo që ka qenë atdhetar dhe me këndo që ai ka mendu që mund
4 të afrohet afër tij ose, domethënë, që është i gatshëm për me
5 çliru vendin ai e ka afru dhe ka bisedu me të. Adem Jashari ka
6 qenë figura kryesore emblematike e Ushtrisë Çlirimtare të
7 Kosovës. Shtabi i Përgjithshëm është në bashkëpunim me Ademin
8 edhe të gjithë të tjerët ose kushdo që të jetë, po figura
9 kryesore është Adem Jashari.

10 PY. Po. Në rreshtat 16 deri në 23 të transkriptit të sotëm,
11 po ju lexoj, po përsëris çfarë thotë transkripti këtu, ju
12 është bërë pyetje lidhur me këtë në këtë incizim, ju pyesin:

13 "Në rregull. Po Shtabi i Përgjithshëm, si mendoni, a
14 kishte një plan apo kishin kontroll lidhur me ato që po
15 ndodhte në zona të ndryshme si në zonën e Llapit, të
16 Dukagjinit, të Drenicës?"

17 Dhe përgjigja jua, flasim gjithmonë për atë që ta
18 kuptojmë, përgjigja që i keni dhënë tek ai videoklip,
19 përgjigja jua sipas tekstit këtu është.

20 "Natyrisht, natyrisht, ka pasur një lloj bashkërendimi.
21 Për shembull, komandanti legjendar Adem Jashari, ai na jepte
22 ne urdhrat."

23 Thjesht, pastër, z. Selimi, ju po na thoni ne që Adem
24 Jashari nuk i raporte askujt. Adem Jashari ishte ai që jepte
25 urdhra, a kam të drejtë?

1 PË. Po, e saktë.

2 PY. Në rregull. Ju bëri pyetje Gjykatësi Barthe për kritikën
3 që kishit ju për z. Jakup Krasniqi dhe Sokol Bashota dhe. Ju
4 kujtohet?

5 PË. Po.

6 PY. Ju na thatë që sipas jush ata nuk ishin profesionistë,
7 nuk kishin përvojë ushtarake, apo jo? Të jemi të qartë.
8 Vërejtjet tuaja lidhur me Jakup Krasniqin ishin, vërejtja juaj
9 apo kritika juaj ishte që nuk ishte ai personi i përshtatshëm
10 për rolin e komandantit sepse ai nuk kishte përvojë ushtarake,
11 nuk ishte profesionist i fushës dhe, sipas jush, ai nuk kishte
12 funksione operative apo komanduese? Saktë?

13 PË. Po, e saktë.

14 PY. Faleminderit.

15 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Kaq pyetje kisha.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
17 znj. Alagendra.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Transkripti s'po punon.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do përpiqemi
20 ta rregullojmë se s'kemi dhe shumë kohë. Në rregull. U
21 rregullua. Presim që të shkojë deri në fund të zbardhet
22 gjithçka që u tha.

23 Z. Selimi, përfundoi dëshmia juaj. Besoj se do ju bëhet
24 qejfi t'ju them që ju përfunduat. Faleminderit që ishit këtu.
25 Mund të largoheni nga salla e gjyqit. Përmbushët detyrimin

1 përpara këtij Trupi Gjykses. Ju urojmë gjithë të mirat.

2 DËSHMITARI: Faleminderit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
4 dhe ju, z. Qerkini.

5 [Dëshmitari largohet]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z. Dixon.

7 Z. DIXON: [Përkthim] Mund të më jepni një çast, ju lutem,
8 unë kam një pyetje për planifikimin se po afron 4 prilli, e di
9 që kemi ende disa javë, po duam të dimë a ka ndonjë ndryshim
10 lidhur me kalendarin pas përfundimit të Prokurorisë. Se duhet
11 të bëjmë dhe ne planifikimet tona dhe të bëjmë parashtrimet
12 përkatëse, do ishte mirë të dinim.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kur të
14 përfundojë Prokuroria, do bëjmë konferencë për ecurinë e
15 çështjes. S'mund të bëjmë plane tani për momentin se nuk na e
16 keni thënë as ju planet tuaja, duhet të na thojë Mbrojtja
17 planet e saj, pastaj të bëjmë ne planet tona pasi të
18 përfundojë Prokuroria.

19 Ne do bëjmë të pamundurën sapo të kemi informacion
20 sigurisht që do t'ua japim në mënyrë që të kemi dhe disa
21 afate, disa data. Po sot s'ju japim dot gjë se nuk dimë
22 synimet tuaja.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Jo, jo, nuk e kisha këtu fjalën. Ne
24 i kemi disa afate që duam për dorëzimin e mocioneve,
25 parashtrimeve.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të dalim
2 me një urdhër të vetëm për të gjitha këto sapo të kemi
3 mundësi, sigurisht që i kemi, jemi të kufizuar. Po e kuptojmë
4 kërkesën tuaj dhe do t'ju informojmë sapo të kemi mundësi.

5 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws,
7 kishit diçka, se dhe ju duhet të informoni ekspertët tuaj. Po.

8 Z. LAWS: [Përkthim] Unë kam dy parashtime të
9 protokolluara që lidhen me masat mbrojtëse që janë ende në
10 pezull. Janë *ex parte*, po unë besoj se këtu mund të flas.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

12 Z. LAWS: [Përkthim] Kam dy dokumente që lidhen me
13 dokumente mase që janë pezull. Janë të dyja *ex parte*, po unë
14 mund të flas për ato.

15 Po, patjetër.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
17 kalojmë në seancë private.

18 [Seancë private]

19 [Seancë private teksti i fshirë]

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11 [Seancë e hapur]

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z. Ellis.

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, thjesht desha

15 të pyesja Prokurorinë nëse ka ndonjë përditësim për

16 dëshmitarët e javës tjetër sepse ne duam të dimë po ashtu cila

17 ditë do punojmë se na ndikon në planet që kemi për të

18 udhëtuar.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Siç e kuptoj

20 unë do ketë vetëm një dëshmitar dhe do jetë vetëm të martën.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Kështu besojmë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju inkurajoj

23 ta gjeni një dëshmitar tjetër të mos çojmë kohë dëm, bëni të

24 pamundurën.

25 Shihemi të martën në orën 9.00 atëherë.

1 Seanca ndërpritet këtu.

2 --- Seanca mbyllet në orën 13.03

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25